



RAPORTI VJETOR 2024:

**Ndjekja e progresit të Shqipërisë në lirinë e
mediave dhe sigurinë e gazetarëve në
përputhje me standardet e BE-së**

RAPORTI VJETOR 2024:

Ndjekja e progresit të Shqipërisë në lirinë e
mediave dhe sigurinë e gazetarëve në
përputhje me standardet e BE-së



SHËNIM

Ky raport, i titulluar “Raporti Vjetor 2024: Ndjekja e progresit të Shqipërisë në lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në përputhje me standardet e BE-së”, u hartua nga një ekip i posaçëm kërkimor i përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme.

Shkrimi dhe zhvillimi i përmbajtjes: Elira Canga, Orkidea Xhaferaj

Redaktimi shkencor: Flutura Kusari

Hartimi i metodologjisë: Lutjona Lula

Shpërndarja e pyetësorit dhe mbledhja e të dhënave: Isa Myzyraj, Osman Stafa

Analiza e të dhënave sasiore: Ilir Brasha

Me kontribut të veçantë: Blerjana Bino, Kristina Voko and Besar Likmeta

Me mbështetje të mëtejshme: Iris Shehaj

Përkthyes (nga anglisht në shqip): Durim Tabaku

Ky raport u përgatit në kuadër të Projektit “Forcimi i Lirisë së Medias, Profesionalizmit dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri”, zbatuar nga BIRN Albania në partneritet me SCiDEV dhe Qendrën Fakte, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e autorëve të raportit dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe partnerëve të projektit.

Tiranë, dhjetor 2024

FALENDERIME

Ky raport është rezultat i përpjekjeve dhe bashkëpunimit të shumë individëve dhe organizatave. U shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë ekipeve në SCiDEV, BIRN Albania dhe Faktoje për kontributin e tyre të paçmuar në hulumtimin dhe mbledhjen e të dhënave.

U jemi, gjithashtu, thellësisht mirënjohës ekspertëve të pavarur që ndanë me ne njohuritë dhe ekspertizën e tyre si dhe gazetarëve dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile që u angazhuan aktivisht në procesin e hulumtimit dhe mbështetjen punën tonë në mbledhjen e të dhënave.

Falënderime të veçanta shkojnë edhe për pjesëmarrësit e aktiviteteve publike të organizuara për të vërtetuar gjetjet me sugjerimet dhe opinionet e të cilëve u pasurua ky raport.

U jemi thellësisht mirënjohës gazetarëve që gjetën kohë për të plotësuar pyetësorin, duke ndarë përvojat dhe mendimet e tyre.

Së fundi, i shprehim mirënjohjen tonë Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri për mbështetjen e tij në realizimin e këtij raporti.

Ky raport pasqyron angazhimin dhe përkushtimin e përbashkët të të gjithë kontribuuesve për avancimin e mëtejshëm e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Shqipëri. Ndonëse është bërë çdo përpjekje për të garantuar saktësinë dhe tërësinë e informacionit të paraqitur, në këtë raport jepen gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e ekipit hulumtues dhe e kontribuuesve. Raporti nuk pretendon të përfaqësojë një panoramë absolute apo përfundimtare të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve, por është një analizë gjithëpërfshirëse e bazuar te të dhënat dhe opinionet e disponueshme në kohën e publikimit.

TABELA E PËRMBAJTJES

FALENDERIME	5
SHKURTIME	9
LISTA E FIGURAVE	10
LISTA E TABELAVE	12
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	13

1.	HYRJE	17
----	-------	----

1.1	Konteksti i lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve	17
1.2	Shqipëria drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian	19
1.3	Qëllimi dhe struktura e raportit	20

2.	METODOLOGJIA	21
----	--------------	----

2.1	Qasja	21
2.2	Hartimi dhe kampioni i sondazhit	21
2.3	Metodat cilësore	26
2.4	Avantazhet dhe kufizimet	29

3.	LIRIA E MEDIAVE DHE SIGURIA E GAZETARËVE NË PROCESIN E ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË BE NË 2024	30
----	---	----

3.1 Rekomandimet e BE-së për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve	30
3.2 Perceptimet dhe përvojat e gazetarëve në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE në 2024	35

4. MASAT E UDHËRRËFYESIT TË SHTETIT TË SË DREJTËS – NDJEKJA E PROGRESIT NË 2024 40

4.1 Përqendrimi i pronësisë së mediave	41
4.2 Matja transparente e audiencës	50
4.3 Dialog i strukturuar për lirinë e medias	51
4.4 Siguria e gazetarëve	55
4.4.1 Perceptimet e përgjithshme për sigurinë	57
4.4.2 Përvojat me sigurinë dhe kërcënimet	59
4.4.3 Siguria e gazetarëve gra	67
4.4.4 Denoncimi dhe reagimi	70
4.4.5 Ecuria drejt dispozitave të udhërrëfyesit lidhur me sigurinë e gazetarëve	77
4.5 Kushtet e punës së gazetarëve	81
4.6 Akses në informacion	84

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME 89

5.1 Përfundime	89
5.2 Rekomandime	90

SHKURTIME

AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AMC	Këshilli Shqiptar i Medias
AMSD	Direktiva për Shërbimin e Mediave Audiovizive
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese
EMFA	Akti Evropian për Lirinë e Medias
ESAP	Platforma e Punësimit dhe Çështjeve Sociale
FIMI	Manipulimi i Informacionit dhe Ndërhyrja e Huaj
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
JIC	Komiteti i Përbashkët i Industrisë
KLGJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
MIA	Agjencia për Media dhe Informim
MPS	Sistemi i Matricës së Ndëshkimit
ODHIR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OJQ	Organizata joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
SAR	Sistemi i Analizës së Riskut
SLAPP	Padi Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike
TV	Televizion

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Profili i të anketuarve sipas gjinisë	22
Figura 2: Profili i të anketuarve sipas grupmoshës	22
Figura 3: Profili i të anketuarve sipas rolit në punë	23
Figura 4: Profili i të anketuarve sipas përvojës në gazetari	24
Figura 5: Profili i të anketuarve sipas llojit të medias ku punojnë	24
Figura 6: Profili i të anketuarve sipas financimit të mediave ku punojnë	25
Figura 7: Profili i të anketuarve sipas nivelit arsimor më të lartë	25
Figura 8: Profili i të anketuarve sipas rrethit ku punojnë	26
Figura 9: Pjesëmarrja në seancat informuese ose konsultimet e mëposhtme	36
Figura 10: Ndërgjegjësimi për kontributin e integritetit evropian në sigurinë e gazetarëve	37
Figura 11: Perceptimi për ndikimin e integritetit në BE në sigurinë e gazetarëve	38
Figura 12: “A jeni në dijeni të Udhërrëfyesve të miratuar nga qeveria shqiptare që ndikojnë në lirinë e medias?”, sipas gjinisë	39
Figura 13: “Gjatë vitit të kaluar, a jeni ndjerë i/e lirë të raportoni për çdo temë pa frikë nga hakmarrja apo censura”	44
Figura 14: Temat ose fushat specifike që e ndjenit veçanërisht të ndjeshme ose të kufizuar për të raportuar gjatë vitit të kaluar, sipas gjinisë	45
Figura 15: Temat ose fushat specifike që ndjeheshin veçanërisht të ndjeshme ose të kufizuara për të raportuar gjatë vitit të kaluar, sipas llojit të mediave ku punojnë të anketuarit dhe roli i tyre në të (më shumë përgjigje)	47
Figura 16: Përqindja e të anketuarve që janë ndjerë në presion për të ndryshuar, vonuar apo braktisur kronika për shkak të një ndikimi nga jashtë, ndarje e hollësishme	48

Figura 17: Lloji i presionit të përjetuar nga gazetarët për të ndryshuar, vonuar apo braktisur kronika, vetëm ata që kanë ndjerë presion	49
Figura 18: Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt – Rastet e sulmeve kundër gazetarëve dhe organizatave të mediave 2020-2024	56
Figura 19: Përmirësim i sigurisë së gazetarëve, kushteve të punës, dhe lirisë së shprehjes krahasuar me një vit më parë	58
Figura 20: Përqindja e të anketuarve që janë sulmuar fizikisht ose janë bërë pre e sulmeve gjatë punës si gazetarë në Shqipëri, sipas kategorive	60
Figura 21: Natyra e sulmeve (vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve)	60
Figura 22: A ndikoi sulmi fizik në raportimin tuaj dhe nëse po, si? (vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve)	61
Figura 23: Përqindja e të anketuarve që kanë përjetuar kërcënime ose frikësim në lidhje me punën e tyre si gazetar, sipas gjinisë	62
Figura 24: Përqindja e të anketuarve që kanë përjetuar kërcënime ose frikësime në lidhje me punën e tyre si gazetar, ndarje sipas kategorive	63
Figura 25: Lloji i kërcënimeve apo frikësimeve me të cilat janë përballur, vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve, sipas gjinisë	64
Figura 26: Shpeshtësia e kërcënimeve dhe frikësimeve të përjetuara sipas gjinisë, vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve	65
Figura 27: Burimet kryesore të kërcënimeve apo frikësimit, vetëm ata që kanë përjetuar diçka të tillë	66
Figura 28: Lloji i kërcënimeve apo kanosjeve me bazë gjinore me të cilat janë përballur gratë, vetëm ato që kanë përjetuar diçka të tillë	67
Figura 29: Në çfarë mase kërcënimet ose frikësimet specifike gjinore kanë ndikuar në raportimin tuaj gjatë vitit të kaluar (vetëm ato që kanë përjetuar diçka të tillë)?	68
Figura 30: Masat e sigurisë për shkak të gjinisë, vetëm gratë	69
Figura 31: Përqindja e gazetarëve që raportuan kërcënimet apo frikësimet te ndonjë autoritet apo institucion, vetëm ata që kanë përjetuar diçka të tillë	70

Figura 32: Arsyet pse gazetarët nuk i kanë raportuar kërcënimet apo frikësimet tek asnjë autoritet apo institucion, vetëm ata që kanë përjetuar diçka të tilla por nuk kanë raportuar tek asnjë autoritet.	71
Figura 33: Autoritetet apo institucionet ku të anketuarit raportuan rastet e tyre të kërcënimeve apo frikësimeve, vetëm ata që raportuan	72
Figura 34: Përgjigjet nga autoritete të ndryshme siç raportohen nga gazetarët, vetëm ata që raportuan rastet e tyre	73
Figura 35: Ndikimi kryesor i kërcënimit apo frikësimit nga burimi, vetëm ata që kanë qenë të kërcënuar apo frikësuar	74
Figura 36: Sfidat kryesore me të cilat përballen gazetarët në Shqipëri kur bëhet fjalë për sigurinë dhe lirinë nga kërcënimet sipas të intervistuarve gazetarë	75
Figura 37: Masat apo veprimet kryesore që gazetarët besojnë se mund të ndihmojnë në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve në Shqipëri	76
Figura 38: “Si ka ndryshuar zbatimi i së drejtës për akses në informacion nga institucionet publike në Shqipëri gjatë vitit të kaluar?”, sipas gjinisë	87
Figura 39: “Si ka ndryshuar zbatimi i së drejtës për akses në informacion nga institucionet publike në Shqipëri gjatë vitit të kaluar?”, sipas përvojës së të anketuarit në gazetari	88

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Kampioni i intervistave	27
Tabela 2: Kërkesa për informacion sipas të drejtës së informimit	28
Tabela 3: Rekomandimet e BE-së për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve 2021-2024	32

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë raport bëhet një vlerësim i ecurisë së Shqipërisë në lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve për vitin 2024. Raporti përqendrohet në zhvillimet dhe sfidat në ekosistemin e mediave në përputhje me kërkesat dhe standardet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE). Për këtë raport është përdorur një metodologji e kombinuar me të dhëna sasiore dhe cilësore për të pasur një analizë sa më të plotë lidhur me situatën e mediave në Shqipëri në procesin anëtarësimit të vendit në BE. Raporti argumenton se, pavarësisht përpjekjeve që janë bërë për të përmbushur standardet e BE-së, ka ende pengesa të mëdha të cilat rrezikojnë pavarësinë, sigurinë, integritetin dhe profesionalizmin e gazetarisë në vend. Situata e lirisë së medias dhe siguria e gazetarëve nuk patën asnjë përmirësim të konsiderueshëm në vitin 2024.

Pavarësisht garancive të Kushtetutës për lirinë e shprehjes, Shqipëria përballlet me probleme të mëdha, si ndërhyrja politike, përqendrimi i madh i pronësisë së medias në pak duar dhe vështirësitë ekonomike që komprometojnë integritetin e gazetarëve. Përpjekjet legjislative, si përafrimi i pjesshëm i legjislacionit të medias me standardet evropiane, nuk i kanë trajtuar ende këto mangësi serioze. Vazhdimi i cilësimit të shpifjes si kundërvajtje penale dhe ndikimi në rritje i platformave digjitale kanë krijuar probleme të reja, përfshirë këtu sulmet kibernetike dhe ngacmimet online.

Anëtarësimi i Shqipërisë në BE ka shenjuar disa momente kyçe në vitin 2024, përfshirë hapjen e negociatave për grup kapitullin 1 dhe 6 në tetor dhe dhjetor 2024 përkatësisht. Shqipëria ka miratuar dy udhërrëfyes kyç në përgjigje të procesit të shqyrtimit dhe për t'u përafruar me standardet e BE-së - Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës dhe Udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike - ku përfshihen dispozita për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve. Megjithatë, në vitin 2024 zbatimi i këtyre dispozitave ishte i ngadaltë. Përveç kësaj, mangësitë në respektimin e këtyre dispozitave minojnë efektivitetin e këtyre masave. Nga ana tjetër, ndikimi i këtyre masave në përmirësimin e mjedisit të favorshëm për gazetari cilësore nuk është arritur ende. Reformat madhore, si dekriminalizimi i shpifjes dhe rritja e transparencës dhe pluralizmit lidhur me pronësinë e medias, ende nuk janë realizuar plotësisht.

Gazetarët në Shqipëri përballen me kërcënime dhe presione në rritje. Edhe pse sulmet fizike ndaj tyre nuk janë fenomen i zakonshëm, gazetarët shqiptarë përballen me presione e kërcënime të shumta, përfshirë këtu paditë gjyqësore dhe ngacmimet online. Kjo situatë kontribuon në krijimin e një mjedisi autocensure dhe pasigurie. Gratë gazetare përballen me sfida të mirëfillta gjinore, veçanërisht me sulme verbale, fushata shpifjeje dhe ngacmime online, të cilat ndikojnë jashtë mase në aftësinë e tyre për të marrë pjesë në sferën publike dhe për të punuar në siguri dhe liri.

Kushtet e pasigurta të punës të gazetarëve shqiptarë nxjerrin në pah dobësitë në sistem. Mungesa e kontratave të punës, pagat e ulëta, pagesat informale, mungesa e sigurisë së vendit të punës dhe mbështetja e kufizuar institucionale krijojnë një mjedis ku presionet dhe ndërhyrjet e jashtme nga pronarët e mediave, bizneset dhe politikanët cenojnë integritetin e gazetarëve. Këto probleme përkeqësohen nga mungesa e transparencës në financimin e mediave dhe pronësia e mediave e përqendruar në pak duar, gjë që u jep përparësi interesave të politikës apo bizneseve ndaj interesit publik dhe llogaridhënies.

Edhe pse Shqipëria ka dispozita ligjore që garantojnë të drejtën e informimit, zbatimi i tyre shpesh bëhet me hope. Gazetarët përballen rregullisht me vonesa nga institucionet publike ose me refuzime të drejtpërdrejta kur kërkojnë informacione të rëndësishme. Për shkak të mungesës së angazhimit institucional dhe vullnetit politik për transparencë proaktive, kombinuar me mungesën e efikasitetit institucional, përqendrimin e informacionit publik dhe përdorimin e propagandës, hasen ende kufizime në marrjen e informacionit, gjë që ua ka bërë edhe më të vështirë gazetarëve të luajnë me efektivitet rolin e tyre mbikëqyrës.

Procesi i anëtarësimit në BE ka sjellë një hov reformash. Gjithsesi, progresi pengohet nga sfidat sistematike, nga mangësitë në respektimin e ligjeve, zbatimi jo i njëtrajtshëm i politikave dhe mungesa e vullnetit të vërtetë politik për transformimin e sektorit të medias. Edhe pse ambicia e shpallur për një proces të përsheptuar të anëtarësimit në BE për Shqipërinë mund të krijojë mundësi për të çuar përpara reformat në sektorin e medias, në hartimin e politikave një gjë e tillë ka rrezik të përkthehet në një qasje “sa për të kaluar radhën” - duke i dhënë kështu përparësi formalitetit dhe jo ndryshimit kuptimplotë, kështu duke pasur një ndikim real fare të vogël. Prioritetet kryesore janë mbrojtja e sigurisë dhe pavarësisë së gazetarëve, rritja

e transparencës dhe pluralizmit në pronësinë e mediave dhe përqendrimin e tregut si dhe përmirësimi i aksesit në informacion. Trajtimi i këtyre problematikave është me rëndësi të madhe për mbrojtjen e lirisë së mediave, garantimin e llogaridhënies publike dhe mbështetjen e proceseve demokratike të Shqipërisë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE.

1. HYRJE

1.1. Konteksti i lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve

Në vitin 2024, në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit¹, Shqipëria u rendit në vendin e 99-të nga 180 shtete duke shënuar një rënie prej tre vendesh krahasuar me një vit më parë.² Kjo renditje nxjerr në pah sfidat e vazhdueshme që hasin liria e mediave dhe siguria e gazetarëve, ku sektori i mediave mbetet tërësisht i ndikuar nga ndërhyrjet politike, presionet ekonomike dhe masat e dobëta mbrojtëse institucionale. Këto probleme strukturore krijojnë një mjedis ku liria e mediave dhe pavarësia e gazetarëve janë nën kërcënim serioz e të vazhdueshëm.

Në Shqipëri, liria e shprehjes mbrohet me Kushtetutë dhe rregullohet nëpërmjet një sërë aktesh ligjore e nënligjore. Megjithatë, respektimi i kësaj të drejte minohet nga kufizimet në praktikën e punës dhe nga mangësitë në zbatimin e ligjeve. Ligji për mediat audiovizive i vitit 2013³, i cili përbën edhe themelin e rregullimit të mediave, u ndryshua pjesërisht në 2023⁴ për t'u përafruar me Direktivën e Shërbimeve të Mediave Audiovizive të vitit 2018.⁵ Edhe pse nëpërmjet këtyre ndryshimeve u trajtuan disa aspekte të politikës evropiane për mediat, kuadri i përgjithshëm ligjor ende nuk është përafruar plotësisht me standardet evropiane. Asgjë nuk ka ndryshuar lidhur me shpifjen, që mbetet ende kundërvajtje penale, dhe me gjoba tejet të mëdha që pengojnë investigimet dhe raportimet e pavarura të gazetarëve.⁶

¹ [Reporterët pa kufi, Shqipëri 2024](#)

² [Reporterët pa kufi, Shqipëri 2023](#)

³ [Ligji Nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"](#)

⁴ [Ligji Nr. 30/2023, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar](#)

⁵ [Direktiva e Shërbimeve të Mediave Audiovizive 2018](#)

⁶ [Shqipëria – Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve 2023. Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt 2024](#)

Nga ana tjetër, mbrojtja ligjore e kufizuar dhe mungesa e efikasitetit të saj për gazetarët që përballen me kërcënime ose sulme i rrisin edhe më shumë vështirësitë për të vepruar në një mjedis mediatik të lirë dhe të paanshëm. Në vitin 2023 Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt raportoi 24 sulme ndaj gazetarëve, ndërsa në vitin 2024 janë raportuar 45 raste kërcënimesh, presionesh dhe sulmesh ndaj gazetarëve dhe organizatave mediatike, ku pjesa më e madhe kanë qenë sulme verbale, ligjërime publik kundër mediave dhe ngacmime online.⁷ Edhe pse Shqipërisë i mungon një përkufizim ligjor i Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPPs), paditë për shpifje mbeten një kërcënim, duke synuar gazetarët dhe mediat investigative.⁸ Po ashtu, varësia në rritje të platformat digjitale për shpërndarjen e lajmeve ka sjellë sfida të reja për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve, si sulmet kibernetike, mashtrimet, ngacmimet online, provokimet dhe heqja e përmbajtjes.⁹

Sektori i medias në Shqipëri karakterizohet nga kushtet e pasigurta të punës, mungesa e kontratave të punës, pagat e ulëta, pagesat informale dhe mungesa e sigurisë së vendit të punës për gazetarët dhe punonjësit e medias.¹⁰ Këto sfida përkeqësohen nga përqendrimi i madh i pronësisë së mediave. Në Monitorimin e Pluralizmit të Mediave 2024¹¹ Shqipëria identifikohet si një nga vendet evropiane me rrezikun më të lartë të përqendrimit të pronësisë së mediave. Mediat shpesh kontrollohen nga individë ose subjekte me përkatësi të qarta politike dhe ekonomike ose me interesa personale,¹² duke çuar në manipulimin e përmbajtjes që u jep përparësi interesave private ndaj interesave dhe llogaridhënies publike.

⁷ [Incidentet – Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt 2024 Shqipëri](#)

⁸ [Liria e mediave në Shqipëri: Raporti Hije 2024 nga SCiDEV dhe OBTC, 2024](#)

⁹ [Raporti për të Drejtat Dixhitale 2024 Shqipëri](#)

¹⁰ [Barometri kombëtar i lirisë së medias në Shqipëri për vitet 2022-2023, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2024](#)

¹¹ [Monitorimi i Pluralizmit të Mediave, 2024](#)

¹² [Monitori i Pronësisë së Mediave, 2023](#)

1.2. Shqipëria drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian

Progresi i Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) karakterizohet nga dy momente kyçe në vitin 2024. E para i referohet hapjes së negociatave me Shqipërinë për grup kapitullin 1 më 15 tetor 2024,¹³ ku përfshihen funksionimi i institucioneve demokratike; reforma në administratën publike; gjyqësori dhe të drejtat themelore; drejtësia, liria dhe siguria; kriteret ekonomike; prokurimi publik; statistikat dhe kontrolli financiar. Në këtë aspekt, Shqipëria ka miratuar Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës (2023)¹⁴ dhe Udhërrëfyesin për Funksionimin e Institucioneve Demokratike (2024),¹⁵ të cilat, ndër të tjera, përfshijnë masa të posaçme që synojnë rritjen e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve. Momenti i dytë është hapja e negociatave për grup kapitullin 6 për Marrëdhëniet me Jashtë më 17 dhjetor 2024,¹⁶ duke përfshirë marrëdhëniet e jashtme dhe politikën e jashtme, atë të sigurisë dhe të mbrojtjes. BE-ja vendosi kritere edhe për mbylljen e përkohshme të këtyre kapitujve si për grup kapitullin 1 ashtu edhe për 6, të përfshirë në qëndrimin e BE-së lidhur me anëtarësimin.

Në konkluzionet e tij të vitit 2024 mbi zgjerimin,¹⁷ Këshilli i Bashkimit Evropian riafirmoi rëndësinë parësore të shtetit të së drejtës si një vlerë thelbësore që është vetë themeli i BE-së. Këshilli theksoi se *sundimi i ligjit përfaqëson një komponent jashtëzakonisht të rëndësishëm të transformimit demokratik dhe një kërkesë thelbësore për ecurinë drejt anëtarësimit në BE*. Këshilli i vuri theksin mbrojtjes së të drejtave themelore si baza e vlerave të BE-së dhe përsëriti rëndësinë e trajtimit të mangësive të raportuara në këtë fushë nëpërmjet marrjes së masave të besueshme. Liria e shprehjes, liria e mediave, mbrojtja e gazetarëve dhe pluralizmi mediatik u identifikuan nga Këshilli si shtyllat themelore të një shoqërie demokratike. Pritet që vendet aspirante, si Shqipëria, të garantojnë respektimin e këtyre parimeve. Këto elemente, ndër të tjera,

¹³ [Njoftim i Këshillit të Bashkimit Evropian, 15 tetor 2024](#)

¹⁴ [Udhërrëfyesi për shtetin e së drejtës](#)

¹⁵ [Udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike](#)

¹⁶ [Njoftim i Këshillit të Bashkimit Evropian, 17-dhjetor 2024](#)

¹⁷ [Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian për Zgjerimin 2024](#)

njihen si jetike për funksionimin e duhur të institucioneve demokratike dhe do të mbeten prioritetë në monitorimin nga BE-ja të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë.

1.3. Qëllimi dhe struktura e raportit

Në këtë raport vlerësohet progresi i Shqipërisë në zbatimin e masave për anëtarësimin në BE lidhur me ruajtjen e lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve. Në raport bëhet një analizë e ndryshimeve institucionale dhe ligjore në vitin 2024 me synim ndjekjen e përmbushjes nga Shqipëria të kërkesave të anëtarësimit në BE dhe standardeve për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve. Nga ana tjetër, në raport shqyrtohen perceptimet dhe përvojat e gazetarëve lidhur me lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve. Gjetjet nga ky raport nxjerrin në pah aspekte të ndryshme të sfidave me të cilat përballen profesionistët e mediave në Shqipëri, duke ofruar një perspektivë të bazuar në të dhëna për mjedisin aktual, i cili, së bashku me vlerësimin e masave, lehtëson monitorimin e progresit, identifikimin e mangësive kryesore dhe evidentojnë fushat që kërkojnë vëmendje të mëtejshme për të përmbushur standardet e BE-së.

Pas Hyrjes ku përshkruhen sfidat me të cilat përballen liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Shqipëri, në raport përshkruhet metodologjia, ku i vihet theksi qasjes me kombinim metodash që integron të dhënat sasiore me ato cilësore. Kapitujt e tjerë fokusohen në fushat tematike, përfshirë rekomandimet e BE-së për lirinë e medias, perceptimet e gazetarëve gjatë procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, zbatimin e masave të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës dhe kushtet e sigurisë për gazetarët. Në raport shqyrtohen edhe sfidat strukturore, si përqendrimi i pronësisë së mediave, transparencja në matjen e audiencës dhe kushtet e punës. Së fundi, në kreun e përfundimeve dhe rekomandimeve jepen mendime që mund të përkthehen në veprime dhe që synojnë forcimin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve.

2. METODOLOGJIA

2.1. Qasja

Në këtë raport përdoret një qasje me metoda të përziera për të monitoruar në mënyrë sistematike progresin e Shqipërisë në lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në përputhje me rekomandimet e BE-së. Raporti mat dhe analizon edhe perceptimet dhe përvojat e gazetarëve duke dhënë një pamje më të rafinuar të mjedisit mediatik dhe duke nxjerrë në pah fushat që kanë nevojë për reforma. Me anë të ndërthurjes së metodave sasiore dhe cilësore të hulumtimit, raporti ofron një bazë të fortë për vlerësimin e përparimit të vendit dhe sfidave aktuale me të cilat përballet ai.

Për këtë raport janë konsultuar burimet ekzistuese të të dhënave dhe raportet mbi lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve, duke u mbështetur tek ato dhe duke ofruar plotësimin e analizave dhe të dhënave të tyre. Ndër dokumentet kryesore të konsultuara janë raportet e pavarura: (i) Raporti i pluralizmit të medias, Treguesit për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve, Barometri Kombëtar për Lirinë e Medias, Raporti i Monitorimit të të Drejtave Digjitale; (ii) raportet vjetore të institucioneve publike dhe planet e veprimit; (iii) Raporti Vjetor i BE-së, Raporti i Sundimit të Ligjit i BE-së; (iv) publikime të tjera përkatëse.

2.2. Hartimi dhe kampioni i sondazhit

Hartimi i raportit përqendrohej në dy objektiva thelbësorë: ndjekja e progresit të Shqipërisë në zbatimin e rekomandimeve të BE-së dhe vlerësimi i përvojave të profesionistëve të medias. Për të mbledhur të dhëna

demografike dhe profesionale nga gazetarët u përdor metoda sasiore. Në sondazhin e administruar¹⁸ në maj dhe qershor 2024 morën pjesë gjithsej 139 gazetarë, ku u siguruan të dhëna lidhur me perceptimet e tyre për lirinë e medias, shqetësimet për sigurinë e gazetarëve dhe kushtet e punës. Në variablat kryesorë u llogaritën rolet profesionale të të anketuarve, vitet e përvojës, formimi arsimor dhe llojet e mediave që përfaqësojnë. Kjo qasje e bën më të lehtë të kuptohet se si ndërveprojnë faktorët sistematikë dhe individët në formësimin e peizazhit të mediave.

Nga 139 gazetarë të anketuar, 51% ishin femra dhe 49% meshkuj. Nga analiza e moshës së të anketuarve evidentohet se shumica (56.1%) ishin të moshës 25-35 vjeç, ndjekur nga 24.5% të grupmoshës 34-44 vjeç. Një përqindje më të vogël e përbënin të anketuarit e moshës nën 25 vjeç (9.4%), 45-54 vjeç (7.2%) dhe 55-64 vjeç (2.9%). Kjo përhapje demografike bën të mundur përfshirjen e gazetarëve të rinj në profesion dhe atyre me përvojë, duke ofruar kështu një larmi këndvështrimesh.

Figura 1: Profili i të anketuarve sipas gjinisë





Figura 2: Profili i të anketuarve sipas grupmoshës



¹⁸ Pyetësori ndëraktiv i përdorur për sondazhin e vitit 2024 mund të aksesohet [këtu](#)

Edhe rolet në punë në grupin e të anketuarve ishin të ndryshme, ku 70% e tyre deklaruan se ishin reporterë, 11% kryeredaktorë dhe 9% redaktorë. Pjesa e mbetur e të anketuarve kishin role të tjera në sektorin e mediave. Gjatë analizimit të viteve të përvojës, të dhënat treguan se 0.7% e të anketuarve kishin më pak se një vit përvojë, 8.6% kishin 1-3 vjet përvojë në punë, 30% kishin 4-6 vjet, 25% kishin 7-10 vjet dhe 35.3% kishte mbi 10 vjet përvojë profesionale, duke nxjerrë në pah një përfaqësim të ekuilibruar të profesionistëve të rinj dhe atyre me përvojë në media.

Figura 3: Profili i të anketuarve sipas rolit në punë





Figura 4: Profili i të anketuarve sipas përvojës në gazetari



Shumica e të anketuarve (70.5%) raportuan se punonin në televizion, ndërsa 20.1% ishin të punësuar në mediat online. Një përqindje e madhe (85.6%) punonin në media private, duke pasqyruar kështu dominimin e subjekteve private në peizazhin mediatik të Shqipërisë.

Figura 5: Profili i të anketuarve sipas llojit të medias ku punojnë





Figura 6: Profili i të anketuarve sipas financimit të mediave ku punojnë




Më shumë se dy të tretat e të anketuarve ishin me diplomë master (72.7%), gjë që tregon se kampioni kishte përgatitje të lartë akademike.

Figura 7: Profili i të anketuarve sipas nivelit arsimor më të lartë



Për sa i përket shpërndarjes gjeografike, pjesa më e madhe e të anketuarve janë me punë në Tiranë (72.7%), ndërsa pjesa tjetër në Elbasan (7.2%), Vlorë (4.3%), Durrës (2.9%) dhe rrethe të tjera të vendit. Ky përfaqësim gjeografik bën të mundur që gjetjet të kapin dinamikën urbane dhe rajonale të mjedisit mediatik.

Figura 8: Profili i të anketuarve sipas rrethit ku punojnë



2.3. Metodatat cilësore

Për të plotësuar të dhënat sasiore, u përdorën metoda cilësore hulumtimi. U zhvilluan intervistat gjysmë

të strukturuar me 6 gazetarë, redaktorë dhe studiues të mediave nga korriku deri në tetor 2024. Këto intervista na dhanë njohuri më të thella lidhur me ndikimet e institucioneve, politikës dhe interesave ekonomike në lirinë dhe sigurinë e medias, duke ndihmuar në kontekstualizimin e gjetjeve të sondazhit dhe identifikimin e dukurive që nuk janë të dukshme duke u bazuar vetëm te të dhënat sasiore.

Tabela 1: *Kampioni i intervistave*

Gjinia	Role
Mashkull	Gazetar
Femër	Gazetare
Femër	Gazetare
Femër	Eksperte për mediat
Mashkull	Ekspert ligjor
Mashkull	Ekspert i transformimit digjital
Femër	Hulumtues i mediave
Femër	Redaktor
Mashkull	Përfaqësues i shoqërisë civile
Femër	Përfaqësues i shoqërisë civile

Nga ana tjetër, u bënë edhe kërkesa për informacion bazuar në të drejtën e informimit, të cilat u dërguan në 12 institucione për të marrë të dhëna dhe dokumente zyrtare për rregulloren e mediave, transparencën dhe për incidentet lidhur me sigurinë e gazetarëve në muajt tetor dhe nëntor 2024.

Tabela 2: Kërkesa për informacion sipas të drejtës së informimit

Institucioni	Përshkrimi i kërkesës
Këshilli i Ministrave	Informacion mbi reformat dhe masat për lirinë e medias, transparencën dhe mbrojtjen e gazetarëve.
Policia e Shtetit	Të dhëna për rastet që lidhen me sigurinë e gazetarëve dhe protokolle të posaçme për mbrojtjen e gazetarëve.
Autoriteti i Mediave Audiovizive	Raportime mbi përmbajtjen e dëmshme dhe transparencën e pronësisë dhe financimit të mediave online.
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Ankesat dhe masat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe transparencën për gazetarët.
Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Kundër Korrupsionit	Të dhëna për veprimet dhe iniciativat ligjore për luftën kundër dezinformimit dhe për rritjen e transparencës në reformat e medias.
Inspektorati i Punës	Të dhëna për punësimin dhe shkeljet e kushteve e punës së gazetarëve, përfshirë këtu edhe respektimin e Kodit të Punës.
Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit”	Informacion për masat për luftën kundër dezinformimit dhe mbrojtjen e proceseve demokratike.
Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik	Raporte dhe vlerësime për reformat në media, sigurinë e gazetarëve dhe bashkëpunimin me institucionet kryesore publike.
Kuvendi i Shqipërisë	Të dhëna për bashkëpunimin dhe mbikëqyrjen e reformave në fushën e mediave, dezinformimin dhe nismat për sigurinë.

Prokuroria e Përgjithshme	Të dhëna për kërcënimet e raportuara, rastet e dhunës digjitale dhe protokollet për trajtimin e incidenteve ku përfshihen gazetarë.
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Të dhëna për tatimin mbi të ardhurat e gazetarëve, respektimin e kodit tatimor në organet e mediave dhe hetimet e shkeljeve që kanë të bëjnë me mediat.

2.4. Avantazhet dhe kufizimet

Nëpërmjet qasjes së metodave të përziera që u përdorën në këtë raport u bë i mundur një vlerësim rigoroz i progresit të Shqipërisë në vitin 2024 drejt përmbushjes së rekomandimeve të BE-së në lidhje me lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve. Nga kombinimi i burimeve dytësore, si raportet dhe dokumentet, sondazhi me gazetarët, intervistat informuese me aktorët e interesit dhe kërkesat për informacione për institucionet publike u bë triangulimi i gjetjeve, duke bërë të mundur të kuptohen sa më mirë sfidat strukturore dhe përvojat individuale. Raporti është i rëndësishëm për procesin në vazhdim të anëtarësimit evropian të Shqipërisë.

Megjithatë, raporti nuk është pa kufizime. Mbështetja te të dhënat e vetë-raportuara nga sondazhi mund të sjellë paragjykime të bazuara në përvojat e perceptuara personale. Për më tepër, ndonëse të vlefshme, kërkesat për informacion sipas të drejtës për informim hasën në përgjigje të kufizuar nga ana e institucioneve dhe në cilësi jo shumë të kënaqshme të informacionit të dhënë. Pavarësisht këtyre kufizimeve, raporti ofron një kornizë të dobishme për monitorimin e progresit dhe identifikimin e përparësive që mund të përkthehen në veprime për rritjen e lirisë së medias dhe sigurinë e gazetarëve.

3. LIRIA E MEDIAVE DHE SIGURIA E GAZETARËVE NË PROCESIN E ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË BE NË 2024

3.1. Rekomandimet e BE-së për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve

Mjedisi i lirë dhe pluralist i mediave është i domosdoshëm për funksionimin e shtetit të së drejtës. Media e pavarur luan një rol kyç duke vepruar si rojtar i demokracisë, duke siguruar llogaridhënie dhe duke fuqizuar qytetarët me lirinë për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacione. Megjithatë, kur media i nënshtrohet presionit ose kontrollit të panevojshëm nga aktorë politikë apo shtetërorë, një gjë e tillë minon jashtë mase lirinë e mediave dhe parimet demokratike.

Gjatë pesë viteve të fundit BE-ja ka e theksuar vazhdimisht rëndësinë e lirisë së medias në raportet e saj të progresit për Shqipërinë. Rekomandimet bien në katër kategori kryesore, duke evidentuar kështu se këto fusha janë shqetësim i vazhdueshëm:

- **Sigurimi i tolerancës zero ndaj kërcënimeve**

Një rekomandim tejet i rëndësishëm ka të bëjë me domosdoshmërinë e eliminimit të kërcënimit ndaj gazetarëve. Sigurimi i një ecurie të vazhdueshme transparente dhe të mirë-dokumentuar të rasteve gjyqësore lidhur me incidente të tilla mbetet me rëndësi të madhe për krijimin e një mjedisi më të sigurt për profesionistët e medias.

- **Trajtimi i përqendrimit të pronësisë dhe transparencës së mediave**

BE-ja ka theksuar në mënyrë të përsëritur rreziqet që sjell përqendrimi i madh i pronësisë së medias në Shqipëri. Mungesa e transparencës në financimin e mediave i përkeqëson edhe më tej këto rreziqe, duke i lënë mediat të cenueshme ndaj ndikimit politik dhe ekonomik.

- **Përmirësimi i kushteve të punës së gazetarëve**

Forcimi i të drejtave të punës dhe atyre sociale të gazetarëve ka qenë një tematikë e përsëritur në rekomandimet e BE-së. Zbatimit i vazhdueshëm i Kodit të Punës është me rëndësi madhore për trajtimin e kushteve të pasigurta të punës që shpesh komprometojnë pavarësinë e gazetarëve.

- **Përmirësimi i vetërregullimit brenda komunitetit të mediave**

BE-ja ka bërë thirrje të vazhdueshme për rritjen e përpjekjeve për vetërregullim të organeve të mediave për të promovuar standardet etike dhe përgjegjshmërinë profesionale, duke nxitur pavarësi më të madhe nga presionet e jashtme.

Shqetësimet kryesore lidhur me lirinë e medias janë shprehur mjaft qartë në raportet e progresit të BE-së (sipas tabelës më poshtë). Aksesimi në informacion ka qenë gjithmonë një element i rëndësishëm parësor për informimin e publikut dhe për krijimin e mundësive për të gërmuar më thellë në çështjet me interes publik. Po ashtu, transparencja e reklamave publike ka qenë një çështje me interes dhe një rekomandim që synon rritjen e paanshmërisë dhe pavarësisë së mediave. Progresi ka qenë i ngadaltë ose i pamjaftueshëm - në përgjithësi - dhe pavarësisht riformulimit në varësi të rasteve konkrete të vitit përkatës, të gjitha këto rekomandime nuk janë përmbushur ende në pjesën më të madhe të tyre.

Tabela 3: Rekomandimet e BE-së për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve 2021-2024

2021 ¹⁹	2022 ²⁰	2023 ²¹	2024 ²²
Të sigurohet një politikë e tolerancës zero për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve si dhe për kërcënimet ndaj mediave, përfshirë në debatin politik dhe në rastet e demonstratave.	Të miratohet një politikë e tolerancës zero për kërcënimin dhe sulmet ndaj gazetarëve si dhe për kërcënimet ndaj mediave, përfshirë debatin politik dhe në rastet e demonstratave.	Të zbatohet tolerancë zero për kërcënimin dhe të ndiqen me efektivitet nga gjyqësori rastet të sulmeve kundër gazetarëve, përfshirë këtu dekriminalizimin e plotë të shpifjes.	Të miratohen ndryshimet në kuadrin ligjor për: (i) rritjen e transparencës së pronësisë së medias, (ii) dekriminalizimin e plotë të shpifjes dhe përafrimin e aspekteve civile të shpifjes me standardet evropiane, bazuar në një dialog të strukturuar dhe gjithëpërfshirës me aktorët e medias.
Të sigurohet që kërkesat ligjore për transparencën e pronësisë dhe financimit të medias, dhe kufizimet e saj, si dhe kërkesat për shpërndarjen e reklamave publike, të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare.	Të sigurohet që kërkesat ligjore për transparencën e pronësisë dhe financimit të medias, dhe kufizimet e saj, si dhe kërkesat për shpërndarjen e reklamave publike, të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare.	Të trajtohet përqendrimi i madh i pronësisë së mediave dhe të rritet ndjeshëm transparenca e financimit të mediave, duke përfshirë rishikimin e kuadrit ligjor për reklamën publike, në përputhje me standardet evropiane	Të zbatohet tolerancë zero për kërcënimin dhe të ndiqen me efektivitet nga gjyqësori rastet e sulmeve kundër gazetarëve; të sigurohet rritja e kapaciteteve të organeve të zbatimit të ligjit për të trajtuar rastet e dhunës, përfshirë rastet e protestave, dhe çështje të tjera penale që lidhen me gazetarët, veçanërisht duke siguruar respektimi e plotë të të drejtave të njeriut në trajtimin e incidenteve me gazetarë, përmes udhëzimeve detyruese, mbledhjes së të dhënave dhe masave për ngritjen e kapaciteteve;
Të zbatohet Kodi i Punës dhe të forcohet mbrojtja e të drejtave të punës dhe ato sociale të gazetarëve shqiptarë.	Të zbatohet Kodi i Punës dhe të forcohet mbrojtja e të drejtave të punës dhe ato sociale të gazetarëve shqiptarë.	Të përmirësohen kushtet e punës për gazetarët, veçanërisht duke forcuar mbrojtjen e vendit të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë dhe duke zbatuar vazhdimisht Kodin e Punës.	Të përmirësohen kushtet e punës për gazetarët, veçanërisht duke forcuar mbrojtjen e vendit të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë dhe duke zbatuar vazhdimisht Kodin e Punës.

¹⁹ [Komisioni Evropian: Raporti i Shqipërisë 2021](#)

²⁰ [Komisioni Evropian: Raporti i Shqipërisë 2022](#)

²¹ [Komisioni Evropian: Raporti i Shqipërisë 2023](#)

²² [Komisioni Evropian: Raporti i Shqipërisë 2024](#)

Është e rëndësishme të sigurohet akses i drejtpërdrejtë dhe transparent i medias tek institucionet qeveritare dhe aktivitetet e tyre si dhe tek informacioni publik faktik jopartiak.	Është me rëndësi parësore që çdo ndryshim i mundshëm në ligjin e medias të jetë në përputhje me Opinionin e Komisionit të Venecias dhe t'i nënshtrohet konsultimit të nevojshëm me organizatat e mediave.	Duhet të krijohen evidenca të qëndrueshme të ndjekjen penale dhe ndëshkimit gjyqësor me qëllim forcimin e sigurisë së gazetarëve.	
	Shqipëria ka ende nevojë të prezantojë legjislacionin për rritjen e transparencës në shpërndarjen e reklamave publike.	Duhet të forcohet monitorimi sistematik dhe raportimi transparent i çështjeve gjyqësore që përfshijnë gazetarë dhe profesionistë të medias.	Është me rëndësi parësore që çdo ndryshim në kuadrin ligjor të jetë në përputhje me standardet evropiane, përfshirë Opinionin e Komisionit të Venecias, dhe t'i nënshtrohet konsultimit të gjerë me organizatat e mediave dhe organizatat e shoqërisë civile bazuar në një dialog të strukturuar dhe gjithëpërfshirës.
Është e rëndësishme të sigurohet akses i drejtpërdrejtë dhe transparent i medias tek institucionet qeveritare dhe aktivitetet e tyre si dhe tek informacioni publik faktik jopartiak.	Është e nevojshme të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i kuadrit ligjor dhe rregullator për të zgjidhur sfidat kryesore që pengojnë pavarësinë e medias, në veçanti përqendrimin e pronësisë së medias dhe transparencën e burimeve të financimit dhe interesave ekonomike, përfshirë këtu edhe financimin publik. Është me rëndësi parësore që çdo ndryshim në kuadrin ligjor të jetë në përputhje me standardet evropiane, përfshirë Opinionin e Komisionit të Venecias, dhe t'i nënshtrohet konsultimit të gjerë me organizatat e mediave dhe organizatat e shoqërisë civile bazuar në një dialog të strukturuar dhe gjithëpërfshirës.		Ligji për të drejtën e informimit është përgjithësisht i harmonizuar me standardet evropiane; megjithatë, duhet të përcaktohen afate më të shkurtra dhe të detyrueshme për përgjigjet drejtuar gazetarëve, bazuar në praktikat më të mira evropiane.

	Duhet të rriten aktivitetet vetërregulluese, veçanërisht nga Aleanca për Gazetarinë Etike, një grupim që bën bashkë aktorët e interesit, përfshirë ata online, të cilët zotohen se do të respektojnë Kodin e Etikës.	Duhet të forcohet më tej zbatimi i së drejtës për akses në informacionin publik.	Duhet të forcohet më tej zbatimi i së drejtës për akses në informacionin publik.
		Vetë-rregullimi ka nevojë të forcohet dhe të mbështetet më tej.	Vetë-rregullimi ka nevojë të forcohet dhe të mbështetet më tej.

Për më tepër, Raporti i Komisionit Evropian për Sundimin e Ligjit²³ për Shqipërinë për vitin 2024 nxjerr në pah çështje të një rëndësie parësore që ndikojnë në lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve. Këto çështje kanë të bëjnë me shqetësimet për pavarësinë e autoritetit rregullator audioviziv, i cili mbetet i cenueshëm përballë presionit politik, dhe me mungesën e transparencës dhe përqendrimin e madh të pronësisë së mediave, të cilat kufizojnë pluralizmin në sektorin e mediave. Po ashtu, shpërndarjes së reklamave shtetërore i mungojnë kriteret e qarta dhe transparente, duke favorizuar shpesh mediat që ndjekin linjën e qeverisë, duke komprometuar kështu pavarësinë e tyre editoriale. Edhe pavarësia e transmetuesit publik është nën vëzhgim për shkak të ndërhyrjeve të shumta politike. Gazetarët përballen me sfida të vazhdueshme, përfshirë këtu sulmet verbale dhe fizike, fushatat e shpifjes dhe paditë SLAPP, gjë që krijon një klimë frike dhe autocensure dhe që minon raportimin e pavarur, cilësor dhe investigativ dhe lirinë e shprehjes. Këto problematika nxjerrin në pah nevojën për reforma që duhet të ndërmerren në sistem me qëllim forcimin e pavarësisë së mediave dhe mbrojtjen e gazetarëve në Shqipëri.


²³ [Raporti i Komisionit Evropian për Sundimin e Ligjit 2024](#)

3.2. Perceptimet dhe përvojat e gazetarëve në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE në 2024

Përplekja e Shqipërisë për anëtarësim në BE përbën një mundësi vendimtare për të avancuar më tej me lirinë e medias. Procesi i integrimit në BE, i bazuar në parime të tilla si shteti ligjor dhe liria e shprehjes, ofron një kuadër të strukturuar për zbatimin e reformave të nevojshme në sektorin e mediave në Shqipëri. Ky kuadër thekson transparencën dhe llogaridhënien, të cilat janë kyçe për kapërcimin e sfidave të vazhdueshme, si transparenca dhe përqendrimi i pronësisë së medias, njëanshmëria politike, aksesin në informacion dhe sigurinë e gazetarëve. Gazetarët duhet të kuptojnë dhe të angazhohen në procesin e anëtarësimit në BE, sepse ky angazhim është me rëndësi të madhe për raportimin e saktë dhe të bazuar në fakte për qytetarët.

Gjithsesi, të dhënat e sondazhit nxjerrin në pah nivele të ndryshme të angazhimit të gazetarëve shqiptarë lidhur me procesin e anëtarësimit në BE. Edhe pse 42% e gazetarëve kanë marrë pjesë në seancat informuese për integrimin në BE, një pjesë e konsiderueshme e tyre (30.2%) nuk janë angazhuar në asnjë aktivitet. Kjo mungesë pjesëmarrje është veçanërisht e theksuar mes atyre me përvojë 7-10 vjeçare në gazetari, gazetarëve dhe individëve që punojnë për mediat online, duke lënë të kuptohet se ka mangësi në përplekjet për informimin e këtyre grupeve.


Figura 9: Pjesëmarrja në seancat informuese ose konsultimet e mëposhtme



Të dhënat nxjerrin në pah tendenca me bazë gjinore në pjesëmarrje dhe ndërgjegjësim. Gazetarët meshkuj janë më shumë të prirur të marrin pjesë në konsultimet për raportin e BE-së (23.9% kundrejt 13.2% për femrat), ndërsa gazetaret gra janë më të angazhuara në konsultime për Kodin e Transmetimit (10.3% kundrejt 5.6% për meshkujt). Nga ana tjetër, gazetarët meshkuj shprehen se janë më shumë të ndërgjegjësuar për ndikimin e procesit të integritimit në BE në sigurinë e gazetarëve. Dallimet gjinore sugjerojnë nevojën për ndërhyrje të përshtatura me qëllim që meshkujt dhe femrat të kenë akses të barabartë dhe të përfitojnë nga seancat informuese dhe konsultimet. Trajtimi i pengesave strukturore që kufizojnë pjesëmarrjen e grave në fusha të caktuara mund të përmirësojë barazinë gjinore në nismat për zhvillimin e medias.


Kur bëhet fjalë për ndërgjegjësimin lidhur me kontributin e integritit në BE në sigurinë e gazetarëve, një e treta e gazetarëve janë të painformuar se si procesi i integritit në BE kontribuon në sigurinë e tyre. Nga të anketuarit që nuk kanë marrë pjesë në konsultime apo seanca informimi, 57.1% raportuan se nuk ishin në dijeni të një kontributi të tillë. Për më tepër, gazetarët e rinj në profesion dhe reporterët me më pak përvojë janë më pak të prirur të mendojnë se integrimi në BE ka ndikim pozitiv në sigurinë e gazetarëve. Kjo mungesë ndërgjegjësimi përbën një pengesë serioze për krijimin e besimit në procesin e BE-së. Për mbushjen e boshllëkut të njohurive, veçanërisht për gazetarët dhe reporterët që janë në hapat e para të karrierës është e nevojshme të bëhen përpjekjet që kanë në fokus rritjen e ndërgjegjësimit përmes seminareve, mentorimit dhe fushatave që lidhen me sektorin e mediave.

Figura 10: Ndërgjegjësimi për kontributin e integritit evropian në sigurinë e gazetarëve



Rreth 39% e të anketuarve mendojnë se procesi i integrimit në BE ka ndikim pozitiv në sigurinë e gazetarëve. Ndërkohë që vetëm 6.5% e shohin këtë ndikim si “të rëndësishëm”, pjesa më e madhe e përshkruan këtë ndikim si “të moderuar”. Gazetarët meshkuj prireshin më shumë ta konsideronin procesin me nota pozitive në krahasim me homologet e tyre gra. Perceptimi i ndikimit të moderuar nxjerr në pah nevojën për rezultate më të prekshme sa i përket sigurisë dhe reformave. Forcimi i mbrojtjes ligjore, sigurimi i ndjekjes penale në mënyrë transparente nga ana e gjyqësorit dhe promovimi i rezultateve të dukshme nga nismat e mbështetura nga BE-ja mund të rrisin besimin dhe të nxjerrin më në pah përfitimet që vijnë nga integrimi në BE.


Figura 11: Perceptimi për ndikimin e integrimit në BE në sigurinë e gazetarëve



Gjysma e të anketuarve nuk janë në dijeni të udhërrëfyesve të miratuar nga qeveria që ndikojnë në lirinë e medias, ndërkohë që gazetarët meshkuj kanë mungesë të theksuar të njohurive për këtë gjë. Është interesante se, edhe pse gazetarët meshkuj duket se janë më të informuar se si ndikon te gazetarët

procesi i integrimit në BE, ata nuk i kuptojnë politikat konkrete dhe hapat rregullatorë që ndërmerr qeveria drejt sigurisë. Ky nivel i ulët njohurish bëhet pengesë që gazetarët të mbrojnë ose t'i shfrytëzojnë këta udhërrëfyes në punën e tyre. Për të rritur efektivitetin e politikave të qeverisë, është me rëndësi parësore që informacioni rreth këtyre udhërrëfyesve të shpërndahet gjerësisht dhe në formate të përdorshme. Bashkëpunimi me organizatat dhe shoqatat e medias mund të bëjë të mundur që gazetarët të kuptojnë dhe angazhohen në këto korniza.

Figura 12: “A jeni në dijeni të Udhërrëfyesve të miratuar nga qeveria shqiptare që ndikojnë në lirinë e medias?”, sipas gjinisë.



Gazetarët që nuk kanë marrë pjesë në asnjë konsultim apo seancë informimi shpesh punojnë në media private (32.8%), media online (39.3%), ose kanë role si reporterë (34%). Këto grupe mund të përballen me pengesa strukturore si kufizime në kohë, mungesë mbështetjeje institucionale ose burime të pamjaftueshme. Gjetje e këtij sondazhi nxjerrin në pah nevojën për fushata të posaçme ndërgjegjësuese, nisma për ngritjen e kapaciteteve dhe konsultime më gjithëpërfshirëse për të maksimizuar përfitimet e integrimit në BE në forcimin e lirisë së medias dhe të sigurisë së gazetarëve në Shqipëri.

4. MASAT E UDHËRRËFYESIT TË SHTETIT TË SË DREJTËS – NDJEKJA E PROGRESIT NË 2024

Në përgjigje të procesit të shqyrtimit analitik²⁴ dhe si pjesë e përgatitjes për hapjen e negociatave të anëtarësimit për grup kapitullin 1, Këshilli i Ministrave më 13 dhjetor 2023, me anë të VKM 736²⁵, miratoi Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës. Në këtë udhërrëfyes përshkruhen masat e posaçme që synojnë trajtimin e sfidave kryesore, përfshirë përqendrimin e pronësisë së mediave; matjen transparente të audiencës, dialogun e strukturuar për lirinë e medias, sigurinë e gazetarëve, kushtet e punës dhe aksesin në informacion. Të dhënat e mbledhura për këtë raport nxjerrin në pah nivelin e progresit të arritur në vitin 2024 për secilën nga masat e përshkruara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës dhe do të paraqiten në kapitujt e mëposhtëm duke integruar të dhënat nga analiza e dokumenteve, përgjigjet ndaj kërkesave për informacion, përgjigjet e sondazhit dhe njohuritë nga intervistat informuese.

Në tetor, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Udhërrëfyesin për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike²⁶, që përfshin masa të posaçme për median dhe zgjedhjet. Disa nga masat e parashikuara janë si më poshtë:

- Ndryshimet legjislative në Kodin Zgjedhor brenda vitit 2026, përmes një konsensusi të gjerë ndërpartiak dhe vullneti politik dhe një procesi të hapur konsultimi gjithëpërfshirës;
- Ndryshimet ligjore për të forcuar efikasitetin, pavarësinë e rregullatorit të medias audiovizive do të miratohen në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias brenda vitit 2026;
- Korniza rregullatore e organeve të tjera që monitorojnë mediat online gjatë zgjedhjeve do të miratohet duke filluar nga viti 2026 e në vazhdim.
- Rritja e sasiore dhe cilësore e monitorimit dhe profesionalizmit në raportimin mediatik gjatë

²⁴ [Raporti i shqyrtimit analitik për Shqipërinë 2023](#)

²⁵ [Udhërrëfyesi i Shtetit të së Drejtës](#)

²⁶ [Udhërrëfyesi për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike](#)

fushatës zgjedhore në çdo cikël zgjedhor, si dhe e kapaciteteve të AMA-s për të kryer monitorimin në mënyrën e duhur, duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2025, nëpërmjet zbatimit të projektit “Modernizimi i studios së monitorimi” nga AMA.

- Krijimi i kapaciteteve për evidentimin e dezinformimit gjatë proceseve zgjedhore në çdo cikël zgjedhor, duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2025, përfshirë target grupet përkatëse.
- Zbatimi i vazhdueshëm i mekanizmave të konsoliduar monitorues nga KQZ-ja në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse mundësohet nga ndryshimet e Kodit Zgjedhor, që shqyrtojnë fushatat digjitale për keqinformim, manipulim dhe ndërhyrje të huaja duke vendosur teknologji të avancuara për analiza në kohë reale, duke bashkëpunuar me platformat e mediave sociale për të zbuluar dhe për të luftuar dezinformimin dhe për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar që synon adresimin e kërcënimeve ndërkufitare

Ky raport nuk vlerëson përparimin në zbatimin e masave lidhur me median dhe zgjedhjet, siç parashikohet në Udhërrëfyesin për Funksonimin e Institucioneve Demokratike, duke qenë se udhërrëfyesi u miratua vetëm në tetor 2024. Vlerësimi i zbatimit të tij do të bëhet në vitin 2025 dhe do të përfshihet në edicionin e vitit 2025 të këtij raporti.

4.1. Përqendrimi i pronësisë së mediave

BE-ja ka rekomanduar vazhdimisht ndryshime në kuadrin ligjor shqiptar për rritjen e transparencës dhe për zgjidhjen e problematikave që lidhen me pronësinë dhe financimin e mediave.²⁷ Me këto ndryshime të propozuara synohet të trajtohet përqendrimi i madh i pronësisë së mediave dhe të përmirësohet transparenca në financimin e mediave, përfshirë rishikimin e kriterëve ligjore për reklamat publike në përputhje me

²⁷ Rekomandime në raportet vjetore të viteve 2021, 2022, 2023, 2024 dhe Raporti i Shqyrtimit Analitik 2023 dhe Raporti i Shtetit të së Drejtës 2024 (Shih Tabelën 3 në këtë dokument)

standardet evropiane. Në mënyrë të veçantë, duhet të miratohen dispozita ligjore për kufizimin e pronësisë së mediave dhe shtrirjen e audiencës, me qëllim sigurimin e pluralizmit mediatik, forcimin e rregullave të transparencës dhe krijimin e mekanizmave ligjzbatuese për hetimin e shkeljeve të rregulloreve të pronësisë. Përparësi duhet të ketë transparenca e financimit dhe pronësisë së mediave, përfshirë këtu interesat e pronarëve në sektorët mediatikë dhe jo mediatikë. Po ashtu, duhet të miratohen rregulla të qarta që rregullojnë shpërndarjen e reklamave shtetërore. Për të mbështetur zgjidhjen e përqendrimit të madh të pronësisë së medias, Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës parashtron masën e mëposhtme: “Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Bizneseve rrit monitorimin e zbatimit të Ligjit për Pronarët Përfutues të miratuar në vitin 2020, me synimin për të garantuar transparencë të plotë të pronarëve fundorë të sipërmarrjeve mediatike deri në vitin 2025, me fokus sipërmarrjet mediatike në shkelje të kërkesave të ligjit.”²⁸ Vlerësimi i zbatimit të kësaj mase do të përfshihet në edicionin e vitit 2025 të këtij raporti.

AMA ka ndërmarrë hapa rregullatorë për rritjen e transparencës së strukturave të pronësisë dhe respektimit të ligjit nëpërmjet miratimit të rregullores “Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të ndryshimeve në strukturën e pronësisë dhe transparencën e të dhënave të lidhura me pronësinë e OSHMA-ve”, sipas Vendimit Nr. 40, datë 26 prill 2024. Ky akt përputhet deri diku me Direktivën e Shërbimeve Mediatike Audiovizive²⁹ dhe përfshin dispozita nga Akti Evropian për Lirinë e Medias (EMFA), i cili synon të përvijojë kërkesat dhe procedurat për vlerësimin e ndryshimeve të pronësisë dhe sigurimin e transparencës së informacionit lidhur me pronësinë për Ofruesit e Shërbimeve të Mediave Audiovizive.³⁰ Gjithashtu, AMA mund të kërkojë bashkëpunim ose të hyjë në marrëveshje për asistencë të ndërsjellë me Autoritetin e Konkurrencës, me qëllim shkëmbimin e informacionit ose marrjen e masave të rëndësishme për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm dhe efektiv të kësaj rregulloreje.

²⁸ [Udhërrëfyesi i Shtetit të së Drejtës](#)

²⁹ Kjo përputhet vetëm pjesërisht me AMSD-në, sepse ka dy dispozita kryesore për pronësinë: Mediave u kërkohet të japin informacione të hollësishme rreth strukturës së tyre të pronësisë, përfshirë pronësinë përfutuese, për të siguruar që publiku të mund të identifikojë se kush i kontrollon ato (pjesërisht të përafruar); Kompanitë e mediave duhet të bëjnë të ditur tek autoritetet rregullatore kombëtare çdo ndryshim në pronësi (e përafruar)

³⁰ [Rregullore e AMA-s, 2024](#)

Aktualisht, përtej kuadrit ligjor, AMA ka përgatitur dhe paraqitur grafikisht në faqen e saj të internetit të dhëna për strukturën e pronësisë dhe transparencën³¹ e shoqërive/individëve të licencuar apo autorizuar nga AMA, si dhe deklaratën e pronarit përfitues të këtyre subjekteve që ushtrojnë veprimtari audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Në përgjigje të një kërkesë për informacion, AMA thekson se me publikimin e strukturës së pronësisë në faqen e internetit përmbush një detyrim në procesin e integritetit në BE. Publikimi i të dhënave të pronësisë së medias në faqen e AMA-s është një hap pozitiv drejt transparencës dhe përputhet me kërkesat e integritetit në BE.³² Megjithatë, ky informacion, që tashmë gjendet edhe në Regjistrin Kombëtar të Bizneseve, nuk arrin të trajtojë problematika më të thella, të tilla si interesat e mirëfillta të biznesit, konfliktet e interesit dhe ndikimet e fshehura të pronarëve të mediave ose personave të lidhur me ta. Pa e zgjeruar transparencën ku të përfshijë edhe këto aspekte të rëndësishme dhe pa mbuluar të gjitha mediat, kjo përpjekje rrezikon të jetë sipërfaqësore, duke ofruar fare pak vlerë në trajtimin e përqendrimit të pronësisë së mediave dhe në promovimin e pavarësisë së vërtetë të tyre.

Bordi i AMA-s miratoi një plan veprimi strategjik (2024-2026)³³ ku përshkruhen objektivat e saj për tre vitet e ardhshme, duke u fokusuar në objektiva administrative dhe institucionale. Ndër të tjera, u theksua nevoja e ndjekjes së hapave proceduralë për miratimin e ndryshimeve në strukturat e pronësisë dhe rritjen e transparencës së pronësisë, në përputhje me Ligjin Nr. 97/2013 dhe direktivën e BE-së 2018/1808.

Edhe me një plan strategjik dhe përafrim me direktivat e BE-së, përpjekjet e AMA-s minohen nga sfida të tilla si pronësia e fshehur dhe interesat e mirëfillta të biznesit, konfliktet e interesit, burimet e pamjaftueshme, rezistenca nga pronarët e mediave të fuqishme dhe mekanizmat e kufizuar të zbatimit. Gjetjet nga sondazhi nxjerrin në pah sfidat e vazhdueshme me të cilat përballen gazetarët në Shqipëri. Shumë prej këtyre sfidave lidhen me implikimet dhe dinamikat e përqendrimit të pronësisë së mediave. Ndonëse pronësia private nuk do të thotë domosdoshmërisht ndikimi i padrejtë në praktikën e gazetarisë, mungesa e mekanizmave të qartë

³¹ [Nënrubrika Transparenca e Pronësisë së Medias](#)


³² Neni 8 i Vendimit nuk është zbatuar ende plotësisht në nënrubrikën e transparencës në faqen zyrtare të AMA-s

³³ [Plani Strategjik i Veprimit \(2024-2026\)](#)

rregullatorë ose vetërregullues – siç janë dispozitat që kufizojnë ndikimin e pronarit në politikën editoriale, vendimet për marrjen në punë dhe shkarkimin e kryeredaktorëve dhe ndarja rigoroze mes marketingut dhe redaksisë – rrit rrezikun e komprometimit të pavarësisë editoriale. Ky dominim ngre shqetësime për pavarësinë editoriale, pasi pronarët privatë shpesh u japin përparësi interesave të biznesit ose politikës dhe jo raportimit të paanshëm.³⁴

Më shumë se dy të tretat e të anketuarve raportojnë se janë ndeshur me kufizime në punën e tyre për të raportuar lirisht, shpesh nga frika e hakmarrjeve apo censurës. Ky perceptim pasqyron ndikimin që kanë interesat e biznesit dhe kontrolli mbi punën editoriale të lidhur me pronësinë e medias, gjë që pengon gazetarinë investigative dhe komprometon integritetin e raportimit.

Figura 13: “Gjatë vitit të kaluar, a jeni ndjerë i/e lirë të raportoni për çdo temë pa frikë nga hakmarrja apo censura”




³⁴ [Monitorimi i pronësisë së medias në Shqipëri, 2023](#)

Kur analizojmë kategori të ndryshme, të dhënat tregojnë se gazetarët meshkuj, reporterët dhe ata që punojnë në televizion shprehen se kanë përjetuar më shumë pengesa në punën e tyre për të raportuar lirisht gjatë vitit të kaluar. Kjo pabarazi nxjerr në pah se si përqendrimi i pronësisë në televizion rrit presionet ndaj gazetarëve, duke kufizuar aftësinë e tyre për të raportuar lirisht dhe duke rritur frikën nga hakmarrja ose censurimi.

Tema me më shumë pengesa raportimi kishte të bënte me korrupsionin, për të cilën 63.3% të të anketuarve deklaruan se kjo ishte një çështje e ndjeshme ose e kufizuar, e ndjekur nga krimi i organizuar (46%) dhe mbulimi i korporatave të mëdha dhe abuzimet ekonomike (38.1%). Dallime të dukshme gjinore u vunë re në raportimet për korrupsionin madhor, ku 72.1% e femrave të anketuara e konsiderojnë atë një temë të ndjeshme ose të kufizuar, krahasuar me 54.9% të të anketuarve meshkuj.


Figura 14: Temat ose fushat specifike që ndiheshint veçanërisht të ndjeshme ose të kufizuara për të raportuar gjatë vitit të kaluar, sipas gjinisë



Fakti që korrupsioni (63.3%), krimi i organizuar (46%) dhe abuzimet e korporatave (38.1%) janë temat më të kufizuara tregojnë rolin e rëndësishme parësore që ka transparenca e pronësisë së mediave në ekspozimin e agjendave të fshehura. Pronësia e përqendruar mund të nxisë mbytjen e zërave dhe fshehjen e këtyre problemeve madhore, duke i bërë edhe më të nevojshme reformat për trajtimin e konflikteve të interesit dhe ndikimin e fshehur. Vetëm 12.9% e të anketuarve treguan se nuk janë ndeshur me pengesa në punën e tyre gjatë vitit të kaluar.

Kur i analizojmë përgjigjet sipas roleve në gazetari të të anketuarve, është mjaft e qartë se janë reporterët dhe redaktorët ata që përballen me më shumë pengesa për tema të ndryshme krahasuar me gazetarët e tjerë (12% e reporterëve dhe 11% e redaktorëve nuk raportuan kufizime, kundrejt 20% të gazetarëve të tjerë). Pabarazia më e madhe është në raportimin për krimin e organizuar, me 48% të reporterëve dhe redaktorëve që përmendin kufizime, krahasuar me 27% të gazetarëve të tjerë. Gazetarët e mediave online u përballën me më shumë kufizime për krimin e organizuar (54%) në krahasim me gazetarët e televizionit (47%), ndërkohë që këta të fundit (42%) raportuan më shumë kufizime në tema si “mbulimi i korporatave të mëdha dhe abuzimet ekonomike”, krahasuar me 32% e gazetarëve të mediave online. Gazetarët që punojnë në mediat e financuara nga OJQ-të raportuan më pak pengesa krahasuar me ata në mediat private ose publike. Gjithsesi, gjetjet për mediat e OJQ-ve dhe mediat publike duhet të interpretohen me kujdes, sepse të dhënat janë vetëm si tregues dhe statistikisht jo të rëndësishme.

Figura 15: Temat ose fushat specifike që ndiheshin veçanërisht të ndjeshme ose të kufizuara për të raportuar gjatë vitit të kaluar, sipas llojit të mediave ku punojnë të anketuarit dhe roli i tyre në të (më shumë përgjigje)




Vetëm 17.3% e të anketuarve raportuan se gjatë vitit të kaluar nuk u është dashur kurrë të braktisin ose të ndalojnë një kronikë apo lajm për shkak të presioneve, vendimeve editoriale, censurës ose autocensurës. Gazetarët gra ishin më të prirura në krahasim me gazetarët meshkuj të braktisnin ose të mos publikonin lajme; rreth 19% e gazetarëve të anketuara janë përballur më shpesh me këtë problem, krahasuar me rreth 10% të meshkujve.

Rreth 44% e të anketuarve kanë përjetuar presion për të ndryshuar, vonuar ose braktisur një kronikë për shkak të ndikimeve të jashtme gjatë vitit të kaluar. Ky presion ka qenë më i theksuar te femrat krahasuar me meshkujt (48.5% kundrejt 39.4%). Gazetarët e punësuar në mediat private (47.9%) kanë raportuar nivele më të larta presioni për të ndryshuar, vonuar ose braktisur kronika të caktuara në krahasim me

homologët e tyre në mediat publike (37.5%) ose mediat e OJQ-ve (8.3%). Gjithashtu, 46.9% e gazetarëve televizivë e kanë ndjerë këtë presion, në ndryshim nga 39.3% e gazetarëve online dhe 30.8% e atyre që punojnë në sektorë të tjerë të medias.


Figura 16: Përqindja e të anketuarve që janë ndjerë në presion për të ndryshuar, vonuar apo braktisur kronika për shkak të një ndikimi nga jashtë, ndarje e hollësishme



Ky presion shpesh lidhet me dinamikën e pronësisë, ku pronarët e mediave ose financuesit e reklamave ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen për të mbrojtur interesat e tyre, duke nxjerrë në pah mjaft qartë ndikimin e dëmshëm të pronësisë së përqendruar të mediave në pavarësinë e gazetarisë. Mes gazetarëve

që kanë përjetuar presion për të ndryshuar, vonuar ose braktisur kronika, 55.7% e tyre raportuan se ky presion vinte nga vetë media ose eprorët, 41% cituan politikanë ose zyrtarë qeveritarë dhe 41% identifikuan interesat e biznesit ose financuesit e reklamave si burim presioni.

Figura 17: Lloji i presionit të përjetuar nga gazetarët për të ndryshuar, vonuar apo braktisur kronika, vetëm ata që kanë ndjerë presion



Kur analizojmë format e presionit, shohim se interesat politike, ekonomike dhe organizative janë burimet kryesore të ndërhyrjes. Kërcënimet dhe frikësimet, kryesisht nga pronarët, reklamuesit dhe politikanët, çojnë në përhapjen e autocensurës mes gazetarëve. Mes të anketuarve që përjetuan presione të tilla, secili prej tyre raportoi se ishte detyruar drejt një forme autocensure për shkak të kërcënimeve ose frikësimit, me gati 20% që pranuan se kishin praktikuar autocensurën, 13.7% e tyre raportuan se e kishin praktikë pune autocensurën dhe 6.6% prej tyre “në një masë shumë të madhe” (6.6%). Transparenca e pronësisë është e një rëndësie parësore për zbutjen e këtyre presioneve duke zbuluar lidhjet dhe duke bërë të mundur rritjen e përgjegjshmërisë në vendimmarrjen editoriale.

4.2. Matja transparente e audiencës

Aktualisht në Shqipëri mungon një sistem transparent i matjes së audiencës, një instrument tejet i rëndësishëm për të garantuar përgjegjshmëri në shpërndarjen e reklamave publike. BE-ja ka theksuar në mënyrë të përsëritur rëndësinë e transparencës në shpërndarjen e reklamave publike për të parandaluar favorizimin dhe keqpërdorimin e burimeve shtetërore, duke bërë thirrje për mekanizma shpërndarjeje objektive dhe të mbështetura në të dhëna. Si pjesë e Udhërrëfyesit të saj për Shtetin e së Drejtës, Shqipëria është angazhuar për ta trajtuar këtë mangësi nëpërmjet masave të tilla si: “AMA ndihmon transmetuesit në sigurimin e një procesi transparent të matjes së audiencës deri në vitin 2028 dhe vazhdon të publikojë Buletinin në lidhje me dinamikat e tregut mediatik në baza vjetore brenda 6 muajve të çdo viti. AMA miraton metodologjinë dhe planin për të ngritur dhe zbatuar një sistem transparent të matjes së audiencës mediatike brenda vitit 2025.”³⁵

Në vitin 2023, AMA nisi diskutimet me grupet e interesit lidhur me ndryshimet e propozuara në ligjin organik, të cilat përfshijnë konceptin e matjes së audiencës. Gjatë këtyre takimeve, AMA prezantoi disa modele për matjen e audiencës të përdorura nga shtetet anëtare të BE-së, të cilat mund të përshtaten me dinamikën e tregut audioviziv në Shqipëri.³⁶ Për më tepër, ndryshimet e propozuara përfshijnë masa për të futur në ligj konceptin e piraterisë televizive dhe për ta ndaluar atë.³⁷

Për vitin 2024, AMA organizoi dy tryeza të rrumbullakëta bazuar në matjet e audiencës. AMA është shprehur se “zbatimi i matjes së audiencës është thelbësor për tregun audioviziv shqiptar. Ai shërben si një instrument i rëndësishëm për evidentimin e ndikimit mediatik të operatorëve të mediave audiovizive në publikun e gjerë, si numri i mediave që arrijnë shikueshmërinë e synuar dhe frekuenca e programeve audiovizive të

³⁵ [Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës](#)

³⁶ [AMA, Raporti Vjetor 2023, f. 6](#)

³⁷ [Njoftim i AMA-s për piraterinë](#)

ndjekura. Një matje e tillë do të ndihmojë edhe në forcimin e transparencës në tregun audiovizual dhe në rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive.”³⁸ Shoqëria civile apo organizatat e mediave nuk ishin pjesë e këtyre tryezave.

Për procesin e matjes së audiencës u krijua një strukturë: Komiteti i Përbashkët i Industrisë (KPI), i zgjedhur nga Ofruesit e Shërbimeve të Mediatike Audiovizive pjesëmarrëse në diskutimet e organizuara nga AMA, i përbërë nga nëntë anëtarë sipas kriterëve të vendosura nga grupet e punës me përfaqësues nga operatorët televizivë.³⁹ Në KPI bëjnë pjesë tre media private kombëtare (TV Klan, Top Channel dhe Vizion Plus), Televizioni Publik RTSH, përfaqësues nga tre televizione rajonale dhe dy përfaqësues nga shoqata e agjencive të reklamave.⁴⁰

Duke qenë se televizioni luan një rol të madh në komunikimin me audiencën, është me rëndësi të krijohet një sistem transparent i matjes së audiencës për të garantuar praktika të drejta të shpërndarjes së reklamave publik. Pa një sistem të tillë, nga shpërndarja e burimeve të reklamave, përfshirë edhe fondet publike, mund të favorizohen në mënyrë padrejtë disa transmetues, duke përkeqësuar problematikat e përqendrimit të tregut dhe duke minuar konkurrencën e ndershme.

4.3. Dialog i strukturuar për lirinë e medias

Një tjetër masë e Udhërrëfyesit është krijimi i një dialogu të strukturuar me mediat në mënyrë gjithëpërfshirëse për të bërë të mundur debatet për reformat kryesore të sektorit, përfshirë nxitjen e vetërregullimit dhe edukimit dhe trajnimit cilësor, por pa specifikuar ndonjë institucion publik që mund të marrë përgjegjësinë dhe të administrojë procesin në zbatimin e tij.

³⁸ Përgjigje për kërkesën për informacion

³⁹ [Njoftimi i AMA-s për krijimin e Komitetit të Përbashkët të Industrisë për Matjen e Audiencës, 2024](#)

⁴⁰ [Ngrihet Komiteti i Përbashkët i Industrisë, 2024](#)

Në Forumin e 10-të vjetor për Zhvillimin e Medias,⁴¹ Ambasadori i BE-së Silvio Gonzato njoftoi një dialog të strukturuar, që do të lehtësohej nga Prof. Mark Marku, dialog që synon të nxisë besimin dhe të prodhojë reforma të zbatueshme nëpërmjet një bashkëpunimit me Këshillin e Evropës.⁴² Në fjalën e tij përshëndetëse, ambasadori Gonzato nënvizoi natyrën e ndjeshme të reformave në media dhe nevojën për një konsultim të gjerë e kuptimplotë: *“Është e qartë se reformat në media janë gjithmonë shumë të ndjeshme dhe duhet të përgatiten në veçanti përmes një konsultimi të gjerë dhe kuptimplotë me aktorët përkatës, përfshirë shoqërinë civile. Kjo është arsyeja pse BE-ja mbështet idenë e një dialogu të strukturuar që përfshin autoritetet shtetërore dhe gjithë aktorët përkatës të sektorit të medias... Sipas mendimit tonë, ky dialog duhet të ketë si synim jo vetëm ndërtimin e besimit midis gjithë aktorëve, por në fund duhet të dalë me propozime konkrete për qeverinë dhe parlamentin se si Shqipëria mund të përmbushë angazhimet e saj në lidhje me BE-në në fushën e lirinë së medias dhe lirisë së shprehjes.”*⁴³ Ky njoftim tregon një varësi të konsiderueshme në mbështetjen ndërkombëtare dhe lehtësimin nga bota akademike për dialogun e strukturuar. Edhe pse autoritetet shtetërore përmenden si pjesëmarrës të mundshëm, përgjegjësia praktike për nisjen dhe drejtimin e dialogut, në realitet, duket se qëndron jashtë kompetencës së qeverisë.

Në përgjigje të një kërkesë për informacion, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin sqaroi qëndrimin e qeverisë, duke thënë: *“Bazuar në gjetjet e Komisionit Evropian (KE) lidhur me lirinë dhe pluralizmin e medias, qeveria shqiptare mbështet plotësisht nevojën për të vendosur një dialog të strukturuar dhe gjithëpërfshirës me sektorin e medias, duke besuar fuqishëm se çdo platformë dialogu për reformimin e sektorit në përputhje me rekomandimet e KE-së shërben për të nxitur diskutimet për vetërregullimin e medias, garantimin e të drejtave të gazetarëve dhe promovimin e profesionalizmit në këtë sektor”.*⁴⁴ Në të njëjtën përgjigje, argumentohet se zbatimi i këtyre angazhimeve, siç përcaktohet në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës 2023-2030, do të monitorohet vazhdimisht nga Ministria e Drejtësisë, si institucioni përgjegjës për Kapitullin 23, i cili mbulon lirinë e shprehjes dhe të drejtat themelore, përfshirë këtu të

⁴¹ [Forumi i 10-të vjetor për Zhvillimin e Medias](#)

⁴² [Deklaratë e SCiDEV për njoftimin e dialogut të strukturuar me median, tetor 2024](#)

⁴³ [Speech of EU Ambassador, 10th Media Development Forum of the OSCE Presence in Albania, tetor 2024](#)

⁴⁴ Përgjigje nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin për kërkesën për informacion, tetor 2024

drejtat e gazetarëve dhe profesionistëve të sektorit të medias. Në të njëjtën mënyrë, Ministria e Drejtësisë do të jetë përgjegjëse edhe për monitorimin e zbatimit të angazhimeve lidhur me funksionimin e sektorit të medias, siç parashikohet në Udhërrëfyesin për Funksionimin e Institucioneve Demokratike.⁴⁵

Pritej nga të gjithë që qeveria të shpallte zyrtarisht dhe të drejtonte dialogun e strukturuar. Edhe pse qeveria publikisht mbështet dialogun dhe i ngarkon Ministrinë e Drejtësisë detyrën e monitorimit, nuk ka asnjë tregues të qartë që një institucion i caktuar qeveritar të ketë marrë drejtimin proaktiv të nismës. Thjesht dhe vetëm monitorimi nuk është sinonim i pronësisë apo i drejtimit të procesit të reformës në mënyrë që të marrë përgjegjësi për rezultatet. Kështu, masa - edhe pse nominalisht në lëvizje - mbetet e paplotësuar, sepse dialogu po lehtësohet nga bota akademike dhe një organizatë ndërkombëtare, pa përfshirje të drejtpërdrejtë apo llogaridhënie nga asnjë institucion qeveritar.

Pas njoftimit nga ambasadori i BE-së për nismën e dialogut të strukturuar, gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2024 nuk pati zhvillime të rëndësishme në këtë drejtim. Ndërkohë, pritet që takimi i parë prezantues i dialogut të strukturuar të organizohet në janar 2025.

Intervistat me aktorët kryesorë të interesit sugjerojnë se suksesi i kësaj nisme varet nga angazhimi i qartë politik si nga qeveria ashtu edhe nga Parlamenti, edhe pse nisma lehtësohet nga bota akademike dhe organizata ndërkombëtare. Vendimmarrja e bazuar në prova transparente dhe në kohë, e udhëhequr nga standardet dhe rekomandimet evropiane, të tilla si opinionet e Komisionit të Venecias, do të jetë me rëndësi të jashtëzakonshme. Aktorët e interesit theksojnë më tej rëndësinë e një metodologjie të qartë dhe afati kohor të përcaktuar për dialogun për të siguruar besueshmëri dhe efikasitet. Për më tepër, është e domosdoshme që ky dialog të ketë përfshirjen aktive si nga aktorët shtetërorë, si institucionet rregullatore dhe legjislativi, ashtu edhe nga aktorët jositetërorë, përfshirë mediat e pavarura, organizatat e shoqërisë civile dhe botën akademike.⁴⁶ Përfshirja e perspektivave të ndryshme do të bëjë të mundur që reformat

⁴⁵ Po aty

⁴⁶ Intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile, Tirana, nëntor 2024

të jenë gjithëpërfshirëse dhe të zgjidhin problemet madhore, si përqendrimi i pronësisë, transparencja e financimit të mediave dhe siguria e gazetarëve. Duke nxjerrë mësim nga nisma të ngjashme të BE-së në vende të tjera, dialogu i strukturuar duhet të ruajë vrullin përmes konsultimeve të rregullta dhe objektivave të matshëm për të krijuar besimin dhe për të arritur reforma të qëndrueshme.⁴⁷

Të tjerë kanë shprehur shqetësimin se dialogu i strukturuar rrezikon të kthehet në një ushtrim i tipit “sa për të kaluar radhën” nga qeveria, që synon vetëm përmbushjen e standardeve të BE-së pa një angazhim të vërtetë për përmirësimin e mjedisit të mediave.⁴⁸ Kritikët argumentojnë se pa mekanizma të qartë llogaridhënieje, pa vazhdimësi të plotë të veprimeve dhe pa vullnet të mirëfilltë politik, dialogu mund të mos zgjidhë problemet e sistemit në këtë sektor, si përqendrimi i pronësisë, ndërhyrja politike dhe mungesa e mbrojtjes për gazetarët.⁴⁹

Një tjetër masë e parashtruar në udhërrëfyesin fokusohet tek Agjencia për Media dhe Informim (MIA), duke bërë të nevojshme një vlerësim të pavarur të agjencisë, veçanërisht në lidhje me transparencën e shpërndarjes së informacionit nga institucionet qeveritare.⁵⁰ Megjithatë, deri më sot nuk është kryer asnjë vlerësim i tillë.⁵¹ Kjo mungesë e mbikëqyrjes është veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se MIA funksionon nën autoritetin e Kryeministrit, duke rikonfirmuar shqetësimet e kahershme për rolin e kësaj agjencie në centralizimin e kontrollit mbi informacionin publik dhe potencialisht duke shtuar një tjetër shtresë paqartësie në qarkullimin e informacionit.⁵²

Pozicioni i negociatave për Shqipërinë në grup kapitullin 6, ndonëse nuk është bërë publik, përshkruan rolin e parashikuar të MIA-s si organ koordinues në nivel të qeverisjes qendrore për të luftuar manipulimin dhe

⁴⁷ Intervistë me ekspert të medias, Tirana, tetor, 2024

⁴⁸ Intervistë me gazetarë, Tirana, tetor, 2024

⁴⁹ Intervistë me gazetarë, Tirana, tetor, 2024

⁵⁰ [Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës](#)

⁵¹ MIA nuk iu përgjigj kërkesës për informacion

⁵² [Artikulli i IPI, 2022](#) dhe [Reporter.al, 2024](#)

ndërhyrjen e informacionit të huaj.⁵³ Ky rol përfshin verifikimin e burimeve të informacionit, garantimin e saktësisë së përmbajtjes së medias dhe bashkëpunimin me organizatat e verifikimit të fakteve dhe Departamentin e Diplomacisë Publike pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Fakti që ky rol i zgjeruar i MIA-s është përcaktuar në pozicionin negociator të Shqipërisë, por nuk është bërë transparent ose nuk i është nënshtruar konsultimit publik, përforcon më tej shqetësimet për përgjegjshmërinë e agjencisë dhe ndikimin e saj të mundshëm në lirinë e medias⁵⁴, si dhe e bën të pavlerë masën e lartpërmendur duke zgjeruar më tej shtrirjen e aktiviteteve të saj pa një proces të mirëfilltë transparence dhe vlerësimin e ndikimit të saj në përhapjen e informacionit.

Nga ana tjetër, duke qenë se është ngritur një komision ad hoc parlamentar për të luftuar ndërhyrjet e huaja dhe dezinformimin⁵⁵, MIA nuk ka qenë pjesë e institucioneve që kanë raportuar në Kuvend dhe roli i saj nuk është parashikuar zyrtarisht në objektin e veprimtarisë së këtij komisioni. Kjo ngre pyetje për koherencën dhe llogaridhënien. Pa përafrimin mes vizionit të qeverisë për MIA-n dhe mbikëqyrjen parlamentare, besimi te veprimtaria e agjencisë dhe aftësia e saj për të kontribuar në përpjekjet transparente dhe të koordinuara kundër dezinformimit mbetet në rrezik, duke përkeqësuar më tej frikën nga kontrolli i centralizuar mbi informacionin publik.⁵⁶

4.4. Siguria e gazetarëve

Gazetarët në Shqipëri përballen me kërcënime, presione dhe frikësime në rritje që vijnë nga aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë të implikuar. Sulmet fizike nuk janë dukuri sistemi në Shqipëri. Raporte dhe

⁵³ Intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile, Tirana, dhjetor 2024


⁵⁴ Intervistë me civil ekspert të medias, Tirana, dhjetor 2024

⁵⁵ Më shumë informacion mund të gjeni në [nënrubrikën e Komisionit Ad Hoc](#)

⁵⁶ Intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile, Tirana, dhjetor 2024

analiza të ndryshme monitorimi kanë nxjerrë në pah një atmosferë të vazhdueshme kërcënimi, fushatash shpifjesh dhe presionesh, duke përfshirë paditë, me pak përmirësim në mbrojtjen e lirisë së shtypit. Në Figurën 18 më poshtë evidentohet rritja e numrit të incidenteve të raportuara të dhunës ndaj gazetarëve në Shqipëri nga viti 2020 në 2024 siç raportohet nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt (SafeJournalists Network),⁵⁷ me një rritje të theksuar në vitin 2024, duke arritur në 45 incidente, të lidhura kryesisht me sulmet verbale dhe debatin anti-media nga aktorët politikë të të gjithë spektrit. Duhet të theksohet se kjo rritje reflekton edhe përpjekje më sistematike për monitorimin dhe rënien e alarmit si dhe rritje të gatishmërisë së gazetarëve për të denoncuar incidentet kur bien pre e sulmeve.

Figura 18: Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt – Rastet e sulmeve kundër gazetarëve dhe organizatave të mediave 2020-2024



⁵⁷ Më shumë informacion mund të gjeni [këtu](#)

Llojet kryesore të shkeljeve janë kërcënimet jofizike, të tilla si ngacmimi verbal dhe kërcënimet, të cilat krijojnë një klimë autocensure dhe ndonjëherë edhe frikë. Sulmet online, përfshirë këtu hakerimin, mashtrimin online (peshkimin - phishing) dhe ngacmimin online, i përkeqësojnë më tej këto problematika, ndërkohë që fjalori kundër mediave dhe gjuha e urrejtjes, shpesh nga figura publike, kontribuojnë në stigmatizimin e gazetarëve. Fushatat e shpifjeve që synojnë diskreditimin e gazetarëve dhe punën e tyre minojnë integritetin e tyre profesional, ndërsa taktikat e frikësimit përdoren për të mbytur zërat e raportimit kritik. Për më tepër, ka pasur 43 padi të regjistruara deri në tetor 2024⁵⁸, duke vënë në pah përdorimin e mekanizmave ligjorë për presionin dhe pengimin e gazetarëve.


Duke qenë se nuk ka pasur përmirësime të rëndësishme në vitin 2024 në lidhje me sigurinë e gazetarëve, në nënkapitujt e mëposhtëm ofrohet një pasqyrë e perceptimeve të gazetarëve për sigurinë e tyre dhe në nënkapitullin e fundit do të shqyrtohet ecuria drejt përbushjes së dispozitave të udhërrëfyesit në lidhje me sigurinë e gazetarëve.

4.4.1. Perceptimet e përgjithshme për sigurinë

Të dhënat e sondazhit nënvizojnë një tendencë shqetësuese të perceptimit lidhur me përkeqësimin e sigurisë së gazetarëve në Shqipëri. Kur të anketuarit u pyetën për ndryshimet në sigurinë e gazetarëve në krahasim me vitin e kaluar, më shumë se gjysma e tyre (54.6%) raportuan rënie të sigurisë, 30.9% tregonin “rënie të ndjeshme” dhe 23.7% “rënie të moderuar”. Vetëm 12.3% vunë re një përmirësim, përfshirë këtu 9.4% që u shprehën për një “përmirësim të moderuar” dhe 2.9% për “përmirësim të ndjeshëm”. Perceptimet për lirinë e shprehjes ishin edhe më negative, me 61.2% të gazetarëve që vunë re një rënie (43.2% “Rënie e ndjeshme” dhe 18% “Rënie e moderuar”), ndërsa vetëm 9.9% thanë se kishte përmirësime (7.2% “Përmirësim i moderuar” dhe 2.9% “Përmirësim i ndjeshëm”).

⁵⁸ Sipas faqes zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe përgjigjes ndaj kërkesës për informacion, 30 tetor 2024

Figura 19: Përmirësim i sigurisë së gazetarëve, kushteve të punës dhe lirisë së shprehjes krahasuar me një vit më parë



Liria e shprehjes shfaqet si fusha më e prekur, duke nxjerrë në pah rritjen e kufizimeve në pavarësinë e gazetarisë dhe në debatin publik. Rënia e ndeshme e sigurisë dhe kushteve të punës thekson më tej sfidat sistematike që pengojnë aftësinë e gazetarëve për të vepruar me efektivitet dhe në siguri.

Kur analizojmë perceptimet sipas roleve të të anketuarve në gazetari, shohim dallime të mëdha. Redaktorët priren më shumë, në krahasim me reporterët ose gazetarët e tjerë, të mendojnë se ka një rënie të sigurisë në krahasim me vitin e kaluar. Në përgjithësi, si redaktorët ashtu edhe reporterët raportojnë vazhdimisht një këndvështrim më negativ në lidhje me sigurinë, kushtet e punës dhe lirinë e shprehjes në krahasim me


të anketuarit në role të tjera. Kjo mund të argumentohet nga kontakti i drejtpërdrejtë dhe nga varësia që redaktorët kanë me pronarët, ose kryeredaktorët, të cilët drejtojnë punën në redaksitë e lajmeve.

Nga ana tjetër, përvoja në këtë fushë luan një rol shumë të rëndësishëm në formësimin e perceptimeve. Gazetarët me më pak se tre vjet përvojë janë më shumë të prirur të besojnë se siguria, kushtet e punës dhe liria e shprehjes janë përkeqësuar gjatë vitit të kaluar, krahasuar me ata me më shumë përvojë në gazetari. Kjo pabarazi mund të nxjerrë në pah rritjen e cenueshmërisë ndaj problematikave në mjedisin mediatik për gazetarët në hapat e parë të karrierës, me sfida si kushtet e pasigurta të punës dhe mungesa e mbështetjes institucionale. Po ashtu, mund të argumentohet se mjedisi sfidues mediatik është bërë diçka normale për gazetarët më shumë vite përvojë, gjë që nga ana tjetër bën që më pak prej tyre të mbajnë një qëndrim publik dhe zyrtar kur bëhen objekt i formave të ndryshme të dhunës.

4.4.2. Përvojat me sigurinë dhe kërcënimet


Rreth 11.5% e të anketuarve raportuan se janë sulmuar fizikisht apo janë bërë viktime të sulmeve të paktën një herë gjatë punës si gazetarë në Shqipëri. Nga të gjithë të anketuarit, pothuajse dy herë më shumë meshkujt (15.5%) sesa femrat (7.4%) kanë përjetuar incidente të tilla. Siç pritej, gazetarët me më shumë vite përvojë ishin përballur më shumë me sulme fizike. Të gjithë ata që raportuan përvoja të tilla punonin në mediat private, por asnjë nga mediat OJQ-të apo mediat publike. Po ashtu, të gjithë gazetarët e dëmtuar ishin reporterë, ku 14.3% që punonin në televizion, krahasuar me 3.6% në mediat online dhe 7.7% në media të tjera.

Figura 20: Përqindja e të anketuarve që janë sulmuar fizikisht ose janë bërë pre e sulmeve gjatë punës si gazetarë në Shqipëri sipas kategorive



Mes gazetarëve që janë sulmuar edhe fizikisht, 63% kanë raportuar se kanë përjetuar një sulm fizik, 11% janë përballur me vandalizëm ose shkatërrim të pronës dhe 11% kanë përjetuar tentativë rrëmbimi. Për më tepër, 5% raportuan se kishin përjetuar fyerje, 5% ishin sulmuar me armë dhe 5% raportuan se në shënjestër të sulmit ishin vënë anëtarët e familjes ose të afërmit e tyre.

Figura 21: Natyra e sulmeve (vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve)




Në 36% të rasteve me sulme, të anketuarit deklaruan se sulmi nuk kishte ndikuar në raportimin e tyre. Megjithatë, në 23% të rasteve ata ndryshuan kronikën për tema të caktuara. Në 18% të rasteve raportuan se kishin përjetuar rritje të ankthit dhe frikës gjatë raportimit, ndërsa në 14% të rasteve kishin shmangur tema apo histori të caktuara. Të anketuarit deklaruan se në 5% të rasteve kërkuan mbështetje ose këshillim dhe në 5% të tjerë morën masa shtesë sigurie.

Figura 22: A ndikoi sulmi fizik në raportimin tuaj dhe nëse po, si? (vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve)




Gati gjysma e të anketuarve (45.3%) kanë hasur në kërcënime ose frikësime lidhur me punën e tyre si gazetarë. Ndarja sipas gjinisë zbulon se një përqindje më e lartë e meshkujve (52.1%) raportuan se kishin përjetuar kërcënime ose frikësime krahasuar me femrat (38.2%).

Figura 23: Përqindja e të anketuarve që kanë përjetuar kërcënime ose frikësim në lidhje me punën e tyre si gazetar, sipas gjinisë



Kur analizojmë dallimet në numrin e gazetarëve që janë përballur me kërcënime ose frikësime që lidhen me punën e tyre, nuk ka ndryshime domethënëse bazuar në vitet e përvojës. Megjithatë, një përqindje më e lartë e gazetarëve që punojnë në mediat publike (62.5%) raportuan përvoja të tilla krahasuar me ata të mediave private (44.5%) ose mediave të OJQ-ve (41.7%). Reporterët (52%) raportuan se u përballën me kërcënime ose me kanosje më shpesh sesa redaktorët (33.3%) ose gazetarët e tjerë (33.3%). Për më tepër, gazetarët që punojnë në televizion kanë më shumë gjasa të përballen me kërcënime ose frikësime në krahasim me ata që punojnë për mediat online.


Figura 24: Përqindja e të anketuarve që kanë përjetuar kërcënime ose frikësime në lidhje me punën e tyre si gazetar, ndarje sipas kategorive



Mes gazetarëve që janë përballur me kërcënime apo frikësime, rreth 89% janë ndeshur me kërcënime verbale, 55.6% kanë përjetuar ngacmime online, 28.6% i janë nënshtruar presioneve ekonomike dhe 7.9% janë përballur me kërcënime ligjore. Kur i analizojmë sipas ndarjes gjinore, nuk ka dallime të mëdha në llojet e kërcënimeve ose frikësimeve të përjetuara.


Kur të anketuarve iu kërkua të jepnin hollësi, ata përmendën marrjen e thirrjeve kërcënuese për të parandaluar publikimin e temave të caktuara, kërcënime të drejtpërdrejta ndaj tyre ose familjeve të tyre, kërcënime me pushim nga puna, etj.

Figura 25: Lloji i kërcënimeve apo frikësimeve me të cilat janë përballur, vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve, sipas gjinisë




Gjatë shqyrtimit të shpeshtësisë së kërcënimeve ose frikësimeve, 14.3% e të anketuarve që kanë përjetuar incidente të tilla kanë raportuar se janë përballur me to shpesh ose shumë shpesh. Mes atyre që u përballën me kërcënime ose frikësim, gratë raportuan se i përjetonin këto situata më shpesh në krahasim me meshkujt, ndonëse në përgjithësi ato përballen me më pak raste kërcënimesh dhe kanosjesh në krahasim me kolegët e tyre meshkuj sipas të dhënave të këtij sondazhi.

Figura 26: Shpeshtësia e kërcënimeve dhe frikësimeve të përjetuara sipas gjinisë, vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve.



Zyrtarët e qeverisë u raportuan nga të anketuarit si burimi kryesor i kërcënimeve apo frikësimit ndaj gazetarëve gjatë vitit të kaluar, ku 49.2% e gazetarëve përjetuan veprime të tilla prej tyre. Më pas vinin kërcënimet nga bizneset dhe organizatat kriminale (të dyja me 28.6%), partitë politike (20.6%) dhe pronarët e mediave (20.6%).

Figura 27: Burimet kryesore të kërcënimeve apo frikësimit, vetëm ata që kanë përjetuar diçka të tillë



Këto gjetje nxjerrin në pah dobësitë dhe mangësitë në sistem lidhur me mbrojtjen e gazetarëve në Shqipëri. Prania e sulmeve të shumta fizike, kërcënimeve dhe kanosjeve – veçanërisht mes reporterëve dhe gazetarëve televizivë – është tregues i nevojës urgjente për mekanizma të konsoliduar sigurie dhe mbrojtje ligjore. Mungesa e plotë e raportimit të sulmeve në mediat e OJQ-ve mund të sugjerojë se këto të fundit zbatojnë protokolle më të mira sigurie apo ofrojnë sisteme mbështetëse, duke ngritur pikëpyetje rreth mbrojtjes së mangët në mediat private, ku ndodhin shumica e sulmeve. Po ashtu, mund të argumentohet se në mediat private, një mjedis i tillë krijon hapësirë për kërcënime ku vetë pronarët e mediave ushtrojnë presion ndaj gazetarëve.


Efekti frenues në lirinë e gazetarëve, që shfaqet në ndryshimin e praktikave të raportimit dhe shmangien e temave të caktuara, nxjerr në pah sfidat me të cilat përballet gazetaria në mbrojtjen e interesit publik. Këto ndryshime minojnë gazetarinë investigative, veçanërisht për tema të ndjeshme si korrupsioni dhe krimi i

organizuar. Duket se ekziston rreziku i kthimit në diçka normale të sulmeve verbale, gjuhës anti-media dhe kanosjeve, gjë që së bashku me mungesën e llogaridhënies institucionale sinjalizon dështimin e sistemit në mbrojtjen e të drejtat themelore të gazetarëve dhe konsolidimin e lirisë së medias për interesin publik.

4.4.3. Siguria e gazetarëve gra


Plot 20.6% e grave gazetare në Shqipëri kanë hasur në kërcënime ose frikësime me bazë gjinore që lidhen me punën e tyre, duke reflektuar një realitet shqetësues për gratë në industrinë e medias. Mes atyre që janë përballur me kërcënime të tilla, dhuna verbale ishte forma më e zakonshme (71.4%), ndjekur nga ngacmimet ose abuzimet online (35.7%), kërcënimet ose ngacmimet fizike (21.4%) dhe ngacmimet seksuale (14.3%). Këto gjetje nxjerrin në pah natyrën e shumëanshme të kanosjeve me bazë gjinore në gazetari.

Figura 28: Lloji i kërcënimeve apo kanosjeve me bazë gjinore me të cilat janë përballur gratë, vetëm ato që kanë përjetuar diçka të tillë



Ndikimi i këtyre kërcënimeve në raportimin e gazetareve gra është mjaft serioz. Rreth 28.6% raportuan se puna e tyre ndikohet “në një masë të madhe”, ndërsa 42.9% thanë se ishte ndikuar “në një masë të moderuar”. Kjo tregon efektin frenues në lirinë e gazetareve dhe aftësinë e tyre për të raportuar me objektivitet për tema të ndjeshme. Nga ana tjetër, 17.6% e gazetareve gra ndiheshin nën presion për të ndryshuar, vonuar apo braktisur një artikull/kronikë të caktuar për shkak të gjinisë së tyre, ndërkohë që reporterët dhe gazetarët e televizionit nuk ndikoheshin njësoj.

Figura 29: Në çfarë mase kërcënimet ose frikësimet specifike gjinore kanë ndikuar në raportimin tuaj gjatë vitit të kaluar (vetëm ato që kanë përjetuar diçka të tillë)?




Mbështetja e organizatave për trajtimin e këtyre shqetësimeve të sigurisë duket e pamjaftueshme. Gati një e treta (29.4%) e gazetareve gra raportuan se shqetësimet e tyre të sigurisë nuk ishin adresuar fare nga media e tyre, ndërsa 19.1% e tjera deklaruan se nuk ishin adresuar në mënyrën e duhur. Një përqindje më e lartë e këtyre rasteve u raportuan në mediat private në krahasim me mediat publike ose të financuara nga OJQ-të, duke ngritur pikëpyetje rreth llogaridhënies institucionale dhe politikave të ndjeshme gjinore në mediat private.

Si përgjigje ndaj këtyre problematikave, vetëm 16.2 e gazetareve gra raportuan se nuk kishin marrë masa sigurie për shkak të gjinisë. Pjesa më e madhe kishin ndërmarrë hapa për të mbrojtur veten, si rritja e masave të sigurisë (41.2%), shmangia e detyrave ose zonave të caktuara (38.2%), kërkimi i mbështetjes nga rrjetet e gazetareve gra (11.8%) ose përdorimi i pseudonimeve ose linjave anonime (7.4%). Është për t'u alarmuar se vetëm 1.5% i raportuan këto incidente në polici, duke treguar mungesë besimi te mekanizmat institucionalë ose frikë nga hakmarrja e mëtejshme.

Për më tepër, 26.5% e gazetareve gra shpesh ose shumë shpesh mendojnë se gjinia e tyre ndikon në mënyrën se si ato trajtohen nga burimet, kolegët ose të intervistuarit. Ky perceptim pasqyron përhapjen e paragjykimeve gjinore në këtë fushë, duke ndikuar në aftësinë e grave për të vepruar si të barabarta me homologët e tyre meshkuj. Vetëm 1.5% e të anketuarave besojnë se ka avantazhe të jesh grua në gazetari, ndërsa një përqindje befasuese prej 82.3% mendojnë se ka disavantazhe të mëdha (38.2%) ose disa disavantazhe (44.1%) në krahasim me meshkujt.

Figura 30: Masat e sigurisë për shkak të gjinisë, vetëm gratë




Këto gjetje nxjerrin në pah dështimin e sistemit në garantimin e një mjedisi të sigurt dhe të barabartë pune për gazetaret gra në Shqipëri. Prania e kërcënimeve me bazë gjinore, mbështetja e pamjaftueshme nga mediat dhe diskriminimi me bazë gjinore në trajtimin nga kolegët dhe burimet nxjerrin në pah nevojën për veprim të menjëhershëm. Mediat duhet t'i japin përparësi zbatimit të politikave të konsoliduara me ndjeshmëri gjinore, të ofrojnë trajnime për sigurinë dhe përfshirjen në vendin e punës dhe të krijojnë mekanizma të qarta raportimi dhe llogaridhënieje për ngacmimet. Nga ana tjetër, shkalla e ulët e raportimit të incidenteve në polici sugjeron mungesë besimi në aftësinë e organeve të zbatimit të ligjit për të trajtuar dhunën me bazë gjinore, duke bërë thirrje për reforma për krijimin e besimit dhe për të garantuar drejtësi për viktimat.

4.4.4. Denoncimi dhe reagimi


Vetëm 18.2% e gazetarëve të cilët u përballën me kërcënime apo frikësim i denoncuan këto incidente tek autoritetet apo institucionet përkatëse. Gazetarët meshkuj prireshin më shumë të raportnin incidente të tilla në krahasim me gazetaret gra (20.6% kundrejt 14.3%).

Figura 31: Përqindja e gazetarëve që raportuan kërcënimet apo frikësimet te ndonjë autoritet apo institucion, vetëm ata që kanë përjetuar diçka të tillë




Arsyeja kryesore që gazetarët që u përballën me kërcënime ose frikësim nuk i raportuan këto incidente tek autoritetet ishte mungesa e besimit tek ato (64.9%). Po ashtu, 45.9% e të anketuarve mendonin se raportimi nuk do të sillte ndonjë ndryshim. Gazetarët gra prireshin më shumë në krahasim me homologët e tyre meshkuj të besonin se raportimi nuk do të ishte produktiv dhe shprehnin frikë më të madhe nga hakmarrja ose ngacmimet të tjera.

Figura 32: *Arsyet pse gazetarët nuk i kanë raportuar kërcënimet apo frikësimet tek asnjë autoritet apo institucion, vetëm ata që kanë përjetuar diçka të tillw, por nuk e kanë raportuar tek asnjë autoritet.*




Përafërsisht 70% e të anketuarve që raportuan rastet e kërcënimit ose frikësimit e bënë këtë në polici, 60% në median e tyre, 40% te një shoqatë gazetarësh apo organizatë mediash, 30% në prokurori, 10% në OJQ dhe 10% në redaksinë e tyre.

Figura 33: Autoritetet apo institucionet ku të anketuarit raportuan rastet e tyre të kërcënimeve apo frikësimeve, vetëm ata që raportuan




Rreth 40% e të anketuarve që i raportuan kërcënimet ose frikësimet e konsideronin reagimin nga policia, prokuroria dhe sindikatat/shoqatat e gazetarëve ose si 'shumë joefektive' (30%) ose 'disi joefektive' në një farë mase (10%). Përveç kësaj, 30% e atyre që i raportuan rastet e tyre i konsideruan reagimet nga mediat dhe OJQ-të si aspak efektive.

Figura 34: Përgjigjet nga autoritete të ndryshme siç raportohen nga gazetarët, vetëm ata që raportuan rastet e tyre




Gazetarët që përjetuan kërcënime ose frikësim nga zyrtarët e qeverisë u përgjigjën kryesisht duke iu shmangur temave të caktuara, me 35% të tyre. Mes gazetarëve që u përballën me kërcënime ose frikësim nga grupet politike, 38% iu shmangën temave të caktuara, ndërsa 20% raportuan rritje të ankthit ose frikës. Në mënyrë të ngjashme, 31% e gazetarëve të kërcënuar nga bizneset shmangën tema të caktuara, të ndjekur nga 20% që ndryshuan metodat e tyre të raportimit. Po ashtu, 31% e gazetarëve që u përballën me kërcënime nga financuesit e reklamave ose pronarët e mediave iu shmangën temave të caktuara. Kur kërcënimet vinin nga organizatat kriminale, 22% e gazetarëve raportuan rritje të ankthit ose frikës. Edhe 16% e gazetarëve të cilët u kërcënuan ose u frikësuan nga kolegët e tyre më pas iu shmangën disa temave.

Figura 35: Ndikimi kryesor i kërcënimit apo frikësimit nga burimi, vetëm ata që kanë qenë të kërcënuar apo frikësuar.




Tre të katërtat e të anketuarve (74.1%) besojnë se mungesa e mbrojtjes ligjore është problemi kryesor me të cilën përballen gazetarët për sa i përket sigurisë dhe lirisë nga kërcënimet. Kjo pasohet nga 71.9% që përmendin presionin dhe ndërhyrjen politike, 62.6% që përmendin mbështetjen e pamjaftueshme nga mediat, 59% që tregojnë presionin ekonomik nga pronarët ose financuesit e reklamave në media dhe 53.2% që theksojnë reagimin e pamjaftueshëm nga organet e zbatimi i ligjit dhe nga gjyqësori.

Figura 36: Sfidat kryesore me të cilat përballen gazetarët në Shqipëri kur bëhet fjalë për sigurinë dhe lirinë nga kërcënimet sipas të intervistuarve gazetarë



Përafërsisht 77.7% e gazetarëve besojnë se forcimi i mbrojtjes ligjore do të rriste sigurinë e gazetarëve në Shqipëri. Po ashtu, 66.2% mendojnë se reagimi më i ashpër nga organet e zbatimit të ligjit dhe nga gjyqësori ndaj kërcënimeve dhe sulmeve do të përmirësonte sigurinë e gazetarëve. Kjo pasohet nga 61.9% që besojnë në nevojën për një vullnet më të madh politik në mbrojtje të lirisë së shtypit, 61.2% që mbrojnë idenë e rritjes së ndërgjegjësimit publik dhe mbështetjes për rolin e gazetarisë dhe 58.3% që mendojnë se do të ishte me shumë përfitim përmirësimi i mbështetjes dhe solidaritetit nga organizatat e mediave.

Figura 37: Masat apo veprimet kryesore që gazetarët besojnë se mund të ndihmojnë në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve në Shqipëri



Këto gjetje nxjerrin në pah dështime të thella në strukturë dhe sistem për mbrojtjen e gazetarëve në Shqipëri. Mungesa e dëshirës për të denoncuar kërcënimet dhe sulmet, shkaktuar nga mosbesimi tek autoritetet dhe nga frika e hakmarrjes, tregon një shpërbërje të konsiderueshme të përgjegjshmërisë institucionale dhe të mekanizmave mbrojtës. Mungesa e perceptuar e efektivitetit të reagimit nga policia, prokurorët, organizatat e medias dhe sindikatat e përkeqëson këtë mungesë besimi, duke bërë që gazetarët të kenë me pak rrugë të mundshme për rekurs.

Efekti frenues i kanosjes është veçanërisht shqetësues, pasi rrezikon integritetin e gazetarëve dhe kufizon aksesin e publikut tek informacioni i rëndësishëm. Shmangia e temave të caktuara për shkak të

kërcënimeve, veçanërisht për çështje me ndjeshmëri të madhe politike apo ekonomike, është sinjal i një dobësimi të gazetarisë investigative dhe mbikëqyrjes demokratike.

Për më tepër, pabarazitë gjinore në raportim dhe cenueshmëria nxjerrin në pah nevojën për ndërhyrje të posaçme me qëllim trajtimin e sfidave të veçanta me të cilat përballen gazetarët gra, përfshirë këtu marrjen e masave të duhura të sigurisë dhe krijimin e mekanizmave për të luftuar kërcënimet dhe kanosjet apo frikësimet me bazë gjinore.

4.4.5. Ecuria drejt dispozitave të udhërrëfyesit lidhur me sigurinë e gazetarëve

Gjetjet nga sondazhi nxjerrin në pah sfidat e gjithanshme me të cilat përballen gazetarët në Shqipëri, përfshirë kërcënimet, frikësimet dhe mungesën e mbështetjes institucionale. Këto problematika përputhen mjaft mirë me përparësitë e përshkruara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, në të cilin propozohen masa kritike për zgjidhjen e këtyre mangësive nëpërmjet reformave ligjore, përforcimit të mekanizmave të monitorimit dhe zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe shoqërisë civile. Në këtë nënkapitull trajtohen këto dispozita të udhërrëfyesit, vlerësohet progresi i arritur dhe identifikohen implikimet që vijnë nga vonesa në zbatimin e masave për sigurinë e gazetarëve dhe pavarësinë e medias.

Për sa i përket masës “Siguria e gazetarëve e garantuar nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të agjencive përkatëse ligjzbatuese”, Këshilli i Evropës vazhdoi me ofrimin e trajnimeve të posaçme për gjyqësorin lidhur me lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve. Po ashtu, organizata të tjera të shoqërisë civile të mbështetura nga donatorë të ndryshëm po punojnë me angazhimin e aktorëve të interesit dhe krijimin e një mekanizmi për përmirësimin e sigurisë së gazetarëve.⁵⁹ Prokurori i Përgjithshëm miratoi një qarkore për hetimin e çështjeve që lidhen me sigurinë e gazetarëve si një hap fillestar drejt krijimit të një mjedisi

⁵⁹ [Takim informues me aktorët e interesit SCiDEV 2024](#)

më të sigurt për gazetarët dhe punonjësit e medias në Shqipëri.⁶⁰

Për sa i përket masës “AMA miraton një Plan Veprimi për sigurinë dhe mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve deri në vitin 2024”, Plani i Veprimit ende nuk është miratuar. Në përgjigje të kërkesës sonë për informacion, AMA argumenton se ka ngritur shqetësime serioze për raste të ndryshme sulmesh ndaj gazetarëve dhe se ka mbështetur disa projekte që trajtojnë sigurinë e gazetarëve në mediat audiovizive.⁶¹

Shqipëria është anëtare e Fushatës së Këshillit të Evropës për Sigurinë e Gazetarëve dhe në vitin 2024 Personi i Kontaktit për Shqipërinë u ndryshua duke kaluar nga Ministria e Punëve të Jashtme në Ministrinë e Brendshme.⁶² Ende nuk është shpallur asnjë plan kombëtar veprimi për sigurinë e gazetarëve, siç kërkohet nga Fushata e Këshillit të Evropës. Megjithatë, në Udhërrëfyes janë përfshirë disa masa specifike.

Lidhur me masën “Analizë e plotë të padive strategjike SLAPP-ve duhet të përfshijë një vlerësim të përhapjes së tyre, ndikimin në lirinë e medias dhe debatin publik dhe përshtatshmërinë e kuadrit aktual ligjor dhe institucional në zgjidhjen e rasteve të tilla. Analiza duhet të identifikojë boshllëqet dhe të propozojë masa korrigjuese, qoftë në ligj apo praktikë institucionale, në përputhje me standardet evropiane dhe acquis të BE-së”, tha në tetor 2024, në një tryezë të rrumbullakët të organizuar nga organizatat e shoqërisë civile, Ulsi Manja, Ministër i Drejtësisë, ku ritheksoi angazhimin e Shqipërisë për të ecur më tej me lirinë e medias duke përfshirë këtu edhe mbrojtjen anti-SLAPP në legjislacionin shqiptar deri në qershor të vitit 2027. Ai pranoi nevojën për procedura më të shpejta ligjore, trajnim të specializuar të gjyqtarëve dhe një dialog të strukturuar për të krijuar një mjedis mbështetës për gazetarinë e lirë.⁶³ Procesi pritet të nisë në vitin 2025 dhe Ministria e Drejtësisë ka kërkuar ekspertizën dhe mbështetjen e Këshillit të Evropës.⁶⁴

⁶⁰ [Qarkore e Prokurorit të Përgjithshëm, tetor 2024](#)

⁶¹ Përgjigje e AMA-s ndaj kërkesës për informacion, tetor 2024

⁶² [Këshilli i Evropës, Shqipëria, Kreu Kombëtar](#)

⁶³ [Tryezë e rrumbullakët për përafrimin e kuadrit ligjor shqiptar me standardet evropiane dhe të KiE-së kundër padive SLAPP](#)

⁶⁴ [Angazhimet publike, 2024](#)

Nuk ka asnjë ligj të posaçëm apo të veçantë në legjislacionin shqiptar që trajton në mënyrë specifike dispozitat që trajtojnë paditë SLAPP. Për të përshtatur direktivën anti-SLAPP⁶⁵ të Bashkimit Evropian dhe Rekomandimin e Këshillit të Evropës,⁶⁶ duhen bërë ndryshime të mëdha në Kodin e Procedurës Civile si dhe në Kodin Penal.⁶⁷ Ndryshimi i këtyre kodeve garanton përcaktimin e treguesve kryesorë për identifikimin e padive SLAPP, pushimin e parakohshëm, përfshirë këtu edhe afatet kohore, barrën e provës, sigurinë e kostove procedurale, rikthimin e kostove ligjore dhe pezullimin e procedimit.⁶⁸

Duke pasur parasysh se paditë SLAPP shpesh ndërthuren me elementë të veprave penale, është me rëndësi shumë të madhe të rishikohet se si ndikojnë procedurat penale në rastet SLAPP. Pushimi i parakohshëm i padive dhe pretendimeve të tjera kundër pjesëmarrjes së publikut është një masë jashtëzakonisht e rëndësishme që duhet të ndërmerret për të nxitur praktikën kundër padive SLAPP.⁶⁹ Dispozitat e Kodit Penal për shpifjen (nenet 119 dhe 120) duhet të rishikohen për të siguruar që ato të mos mbështesin pa dashje paditë SLAPP ose të pengojnë lirinë e shprehjes. Për më tepër, zbatimi me sukses i dispozitave kundër padive SLAPP kërkon programe trajnimi për gjyqtarët, avokatët dhe profesionistët e ligjit. Ndryshimet ligjore anti-SLAPP duhet të monitorohen rregullisht dhe duhet të krijohen mekanizma kontrolli për të vlerësuar efektivitetin e masave të reja mbrojtëse ligjore.⁷⁰

⁶⁵ [Direktiva e BE-së kundër padive SLAPP](#)

⁶⁶ [Rekomandimet e Këshillit të Evropës kundër padive SLAPP](#)

⁶⁷ [Dokument pune: Vlerësimi Fillestar i Kuadrit Ligjor të Shqipërisë për Harmonizimin e Direktivës Anti-SLAPP \(Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike\)](#)

⁶⁸ [Vlerësimi rajonal bazë i nevojave legjislativë dhe politike për zbatimin e standardeve të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian për luftën kundër përdorimit të padive SLAPP-ve, dhjetor 2024](#)

⁶⁹ [Vlerësimi rajonal bazë i nevojave legjislativë dhe politike për zbatimin e standardeve të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian për luftën kundër përdorimit të padive SLAPP-ve, dhjetor 2024](#)

⁷⁰ [Dokument pune: Vlerësimi Fillestar i Kuadrit Ligjor të Shqipërisë për Harmonizimin e Direktivës Anti-SLAPP \(Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike\)](#)

Së fundi, miratimi i një ligji të veçantë kundër SLAPP⁷¹, së bashku me ndryshimet si në Kodin e Procedurës Civile ashtu edhe në Kodin Penal, konsiderohet si një element kyç në luftën kundër padive SLAPP në vend.

Për sa i përket masës “Akademia e Policisë vijon të ofrojë trajnime, duke përfshirë edhe ndjekjen e rasteve të dhunës ndaj gazetarëve që nga viti 2024, bazuar në planifikimin vjetor”, në shtator 2024 Akademia e Policisë në bashkëpunim me Unionin e Gazetarëve organizuan një trajnim (dyditor) për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve. Në datën 16.08.2023 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit miratoi një urdhër të veçantë (nr. 1180) për miratimin e procedurës standarde për planifikimin e shërbimeve të Policisë gjatë protestave në lidhje me gazetarët. Gjatë vitit 2024, Këshilli i Evropës mbështeti policinë për hartimin e një protokollit për trajtimin e rasteve të sulmeve kundër gazetarëve dhe punonjësve të medias. Me urdhër 1399, datë 21.10.2024, nga Policia e Shtetit u krijua një grup pune për hartimin e Protokollit për Mbrojtjen e Gazetarëve dhe Trajtimin e Rasteve të Sulmeve. Protokollit duhet të konsultohet me organizatat e mediave dhe gazetarët përpara miratimit.

Lidhur me masën “Policia e Shtetit dhe shërbimet e prokurorisë përcaktojnë një pikë kontakti brenda strukturave të tyre, përgjegjëse për trajtimin e sulmeve ndaj gazetarëve, deri në vitin 2024 dhe garantojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për raste të tilla, nga viti 2024 e në vazhdim”, Prokuroria e Përgjithshme në tetor 2024 caktoi një këshilltar për mediat si person kontakti për denoncimet dhe ndjekjen e rasteve të sulmeve kundër gazetarëve dhe punonjësve të mediave. Policia e Shtetit ende nuk e ka caktuar personin e kontaktit për sigurinë e gazetarëve.

Në lidhje me masën “Prokuroria e Përgjithshme publikon rast pas rasti rezultatet e hetimeve për çështjet me gazetarë, nga viti 2024 e në vazhdim”, Prokuroria e Përgjithshme miratoi një qarkore për hetimin e çështjeve që lidhen me sigurinë e gazetarëve si një hap i parë i rëndësishëm drejt krijimit të një mjedisi më të sigurt për gazetarët dhe punonjësit e medias në Shqipëri. Publikimi rast pas rasti i rezultateve nuk është

⁷¹ [Vlerësimi rajonal bazë i nevojave legislative dhe politike për zbatimin e standardeve të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian për luftën kundër përdorimit të padive SLAPP-ve, dhjetor 2024](#)

bërë ende për vitin 2024. Deri më 22 tetor 2024 është raportuar vetëm një rast sulmi nga një gazetar dhe çështja është në hetim sipas Prokurorisë së Përgjithshme.⁷²

Për masën “Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) mbledh dhe nxjerr të dhëna për rastet e përfshirjes së gazetarëve, nga viti 2023 e në vazhdim”, KLGJ-ja ende nuk i ka publikuar këto të dhëna për vitin 2024. Sistemi online ofron statistika për numrin e rasteve që përfshijnë gazetarë/punonjës të medias, por nuk është e mundur të dallohet se për çfarë arsye, periudha dhe nëse ka lidhje me punën si gazetar i çështjeve private. Nuk disponohet informacion për ecurinë e masës “Shkolla e Magjistraturës bën të mundur trajnimin e gjyqtarëve për trajtimin e duhur të padive SLAPP”. Megjithatë, Shkolla e Magjistraturës bashkëpunon me organizata dhe donatorë të ndryshëm për të ofruar trajnime për gjyqtarët dhe prokurorët.

Vonesat dhe boshllëqet në zbatimin e dispozitave të udhërrëfyesit kanë implikime të rëndësishme për sigurinë e gazetarëve dhe pavarësinë e medias në Shqipëri. Përhapja e vazhdueshme e kërcënimeve, frikësimeve dhe presioneve, përfshirë këtu edhe proceset gjyqësore, ka një efekt frenues për gazetarinë me interes publikut, duke minuar kështu llogaridhënien dhe mbikëqyrjen demokratike.

4.5. Kushtet e punës së gazetarëve

Kushtet e punës së gazetarëve në Shqipëri karakterizohen nga paqëndrueshmëria, paga e pamjaftueshme dhe mungesa e masave mbrojtëse profesionale. Shumë gazetarë punojnë me marrëveshjeve informale ose kontrata të përkohshme pune, me mundësi fare të pakta për të negociuar. Në disa raste, nuk ka kontrata të mirëfillta pune për gazetarët dhe punonjësit e medias. Edhe në rastet kur kanë kontrata të tilla, gazetarëve nuk u jepet një kopje e kontratës, duke u mohuar atyre mundësinë për të njohur zyrtarisht të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe ta përdorin atë si pikënisje negociimi, apo edhe për ta përdorur si provë për padi

⁷² Përgjigje ndaj një kërkesë për informacion, tetor 2024

në gjykatë në rast shkeljesh. Duke pasur parasysh një realitet të tillë, gazetarët mbeten të pambrojtur kur papritur humbasin vendin e punës dhe kur shfrytëzohen.⁷³ Pagat formale në sektorin e medias janë përgjithësisht të ulëta, shpesh të pamjaftueshme për të përmbushur standardet bazë të jetesës dhe gazetarët shpesh përballen me vonesa në marrjen e pagave.⁷⁴ Për më tepër, në vitin 2024 disa media private, të cilat janë përballur me probleme financiare, nuk kanë paguar kontributet shoqërore dhe shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi, duke përkeqësuar më tej sigurinë ekonomike të gazetarëve dhe punonjësve të medias.⁷⁵ Këto kushte të pafavorshme shoqërohen nga kufizimet për sigurimet shëndetësore dhe përfitimet e tjera, duke i detyruar gazetarët të punojnë në rrethana me stres të madh dhe në pasiguri.⁷⁶ Për më tepër, mungesa e mbrojtjes së plotë të të drejtave të punës dhe të negociatave kolektive e përkeqëson edhe më tej situatën e tyre të pasigurt.⁷⁷ Ky mjedis sfidues minon pavarësinë dhe integritetin e tyre profesional, shpesh duke çuar në autocensurë apo nënshtrim ndaj presioneve të jashtme, përfshirë këtu edhe ndikimet politike dhe ekonomike.

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (42.4%) raportuan një përkeqësim të kushteve të punës gjatë vitit të kaluar, ndërkohë që vetëm 21.6% vunë re përmirësime. Kjo nxjerr në pah një perceptim të përhapur mes profesionistëve të medias lidhur me përkeqësimin e kushteve të punës. Mungesa e mbrojtjes së konsoliduar ligjore u evidentua si një problem madhor, e cituar nga 74.1% e gazetarëve. Kjo mungesë e garancive ligjore ndikon ndjeshëm në sigurinë e tyre ekonomike. Gratë dhe gazetarët e rinj në profesion prireshin më shumë të perceptonin përkeqësimin e kushteve të punës, ku gazetarët gra raportonin edhe më shumë raste të problemeve me bazë gjinore, përfshirë kërcënimet dhe frikësimet.

Nga data 1 janar deri më 20 shtator 2024, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka kryer 34 inspektime në 31 subjekte mediatike, duke zbuluar gjithsej 79 shkelje. Nga analiza e shkeljeve

⁷³ SCiDEV, Shqipëria – Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve 2023

⁷⁴ Barometri kombëtar i lirisë së medias në Shqipëri për vitet 2022-2023, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2024

⁷⁵ Intervistë me gazetarë, Tirana, shtator 2024

⁷⁶ Intervistë me gazetarë, Tirana, shtator 2024

⁷⁷ Intervistë me ekspert të medias, Tirana, tetor 2024

kemi një çekuilibër të theksuar në praktikat e punësimit, ku 60% e shkeljeve lidhen me rregullimin e marrëdhënieve të punës. Më konkretisht, rastet e mospagesës për orët jashtë orarit të punës, pushimet dhe turnet e natës kanë qenë të shpeshta, duke dëmtuar 18 punonjës mediash, 3 prej të cilëve femra dhe 15 meshkuj. Po ashtu, u konstatuan se 16 punonjës kanë punuar më shumë se 40 orë që parashikon ligji, ku pabarazia gjinore sërish është e dukshme. Një përqindje më e vogël e shkeljeve (22%) lidheshin me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës, duke sugjeruar një rrezik të konsiderueshëm për mirëqenien fizike të punonjësve të sektorit të medias. Pjesa tjetër prej 18% e shkeljeve kishte të bënte me praktikat informale të punësimit, duke nxjerrë në pah një problem të vazhdueshëm që lidhet me “informalitetin gri”.⁷⁸

Edhe pse në sektorin e medias ka mospërputhje sistematike lidhur me ligjet që rregullojnë të drejtën e punës, reagimi nga agjencitë e përmbarimit duket i pamjaftueshëm. Thjesht ofrimi i rekomandimeve pas inspektimeve nuk arrin të zgjidhë problemet themelore, sepse këto shkelje vazhdojnë pa pengesa apo sanksione konkrete. Është për t'u thekuar se ka pak shenja që Inspektorati i Punës ose Drejtoria e Tatimeve të kenë ndërmarrë masa ndëshkuese kundër mediave që nuk paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Këto modele nënvizojnë një problem më të gjerë në sistem që shkon përtej shkeljeve të mediave të caktuara.

Sipas Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore pritet të miratojë deri në vitin 2025 një metodologji inspektimi të bazuar në risk për të zbatuar në mënyrë efektive të drejtat e punës së gazetarëve.⁷⁹ Inspektorati Shtetëror i Punës ka hartuar një metodologji të tillë inspektimi për të përmirësuar praktikat e të drejtave në punë, duke siguruar që gazetarët të mund të ushtrojnë lirshëm profesionin e tyre dhe për të qenë të përgatitur ndaj kërcënimeve dhe dezinformimeve. Në vitin 2023, me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) në kuadër të Projektit ESAP 2, Inspektorati vuri në zbatim Matricën e Përmirësuar të Dënimeve (MPD 2.0) për zbatimin uniform të ligjit dhe prezantoi Sistemin e Analizës së Riskut duke përdorur teknologji të avancuara si “miniera e

⁷⁸ Përgjigje ndaj kërkesës për informacion nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, tetor 2024

⁷⁹ [Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës](#)

të dhënave” dhe “mësim me teknologji” për planifikimin efikas të inspektimit.⁸⁰ Këto sisteme synojnë të përmirësojnë efektivitetin dhe produktivitetin e inspektimeve dhe aktualisht janë duke u përmirësuar. Në përgjigje të një kërkesë për informacion, nuk u përcaktua se sa në punë u hyjnë këto sisteme gazetarëve dhe mediave dhe si do të zbatohen ato.

Pritet që Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) të vazhdojë me organizimin e programeve të trajnimit që kanë në fokus stafin e Inspektoratit Shtetëror të Punës.⁸¹ Këto programe janë hartuar për ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve në kryerjen e inspektime të bazuara në risk, me fokus të drejtat e punës së gazetarëve. Megjithatë, informacioni i publikuar lidhur me ecurinë e këtyre nismave të trajnimit ose ndikimit të tyre praktik në përmirësimin e kushteve të punës së gazetarëve është i kufizuar.

4.6. Aksesimi në informacion

Aksesimi në informacion në Shqipëri mbetet një problem madhor, duke nxjerrë në pah çështje më të mprehta lidhur me transparencën dhe llogaridhënien. Pavarësisht ekzistencës së një kuadri ligjor që garanton aksesin tek informacioni publik, zbatimi është shpesh me hope.⁸² Institucionet publike në pjesën më të madhe të rasteve nuk iu përgjigjen kërkesave për informacion brenda afateve ligjore, duke përmendur arsye të paqarta ose të pajustificuara për arsyet e refuzimit për dhënien e informacionit.⁸³ Mungesa e dhënies së përgjigjeve ndërlikohet nga mekanizmat e papërshtatshëm të zbatimit të ligjit, duke i lënë kërkuuesit e informacionit me pak mundësi për të bërë rekurs. Nga ana tjetër, ekziston një tendencë shqetësuese e mosdhënies së informacionit me pretekstin e mbrojtjes së privatësisë ose për arsye të sigurisë kombëtare,

⁸⁰ Përgjigje ndaj kërkesës për informacion, tetor 2024

⁸¹ [Udhërrëfytyrë për Shtetin e së Drejtës](#)

⁸² [SCiDEV, Shqipëria – Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve 2023](#)

⁸³ [Fjalimi i Komisionerit në Konferencën VI për të Drejtën e Informimit, 2024](#)

edhe kur këto justifikime janë të papërligjura.⁸⁴ Situata përkeqësohet nga ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm i publikut për të drejtën e informimit dhe rrugët për ndreqjen e situatës, duke marginalizuar edhe më shumë shoqërinë civile dhe gazetarët që varen nga një akses i tillë për punën e tyre.⁸⁵

Në tre tremujorët e parë të vitit 2024, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori 286 ankesa lidhur me refuzimin e dhënies së informacionit dhe dokumenteve zyrtare. Nga këto, 218 raste u zgjidhën me dhënien e informacionit të kërkuar gjatë procesit të shqyrtimit administrativ.⁸⁶ Me kalimin e viteve, neglizhenca e përhapur është e vazhdueshme, siç tregohet nga fakti se mbi 70% e ankesave zgjidhen vetëm pas fillimit të një shqyrtimi administrativ nga Zyra e Komisionerit.⁸⁷ Kjo mënyrë reagimi minon perceptimin publik për transparencën dhe bëhet barrë për burimet administrative. Intervistat me ekspertët ngrenë kritika ndaj Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke deklaruar se Komisioneri i duhet shumë kohë për t'iu përgjigjur ankesave të gazetarëve, duke kontribuar më tej në humbjen e vulltit për punë të veçanta me të cilat po merren në kohën e nevojës së informacionit. Një shqetësim tjetër është se Komisioneri nuk merr gjithmonë një vendim për rastet e ankesave.⁸⁸ Kritikët argumentojnë se Komisioneri shpesh ngurrn të vendosë sanksione të rënda ndaj institucioneve publike që nuk përmbushin kërkesat për dhënie informacioni.⁸⁹

Në vitin 2024, kjo tendencë shqetësuese nuk pati ndryshime duke qenë se drejtuesit e autoriteteve publike vazhduan t'i jepnin përparësi përditësimeve në kohë reale të llogarive të tyre private në platformat e mediave sociale, duke lënë pas dore Programin e Transparencës që është kërkesë e ligjit, program që është i një rëndësie madhore për garantimin e llogaridhënies dhe aksesit të publikut në informacion.⁹⁰ Ka rezistencë

⁸⁴ [SCiDEV, Shqipëria – Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve 2023](#)

⁸⁵ Intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile, Tirana, shtator 2024

⁸⁶ Përgjigje ndaj kërkesës për informacion, shtator 2024

⁸⁷ [Fjalimi i Komisionerit në Konferencën VI për të Drejtën e Informimit, 2024](#)

⁸⁸ Intervistë me gazetar, Tirana, shtator 2024

⁸⁹ Intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile, Tirana, shtator 2024

⁹⁰ Intervistë me gazetar, Tirana, shtator 2024

dhe mungesë ndërgjegjësimi brenda administratës për të bërë publik informacionin pa pasur nevojë për të bërë kërkesë. Detajet kryesore, të tilla si biografitë e zyrtarëve, përditësimi i legjislacionit, rregulloret, të dhënat e ekzekutimit të buxhetit, kontratat dhe shërbimet për qytetarët, shpesh anashkalohen.⁹¹ Autoritetet herë pas here refuzojnë të japin informacione, duke përmendur pa asnjë arsye ligjore dëmtimin e mundshëm të shtetit ose pa bërë vlerësim të interesit publik, duke shkelur kështu të drejtat kushtetuese.⁹² Kërkesat delegohen jo në mënyrën e duhur ndërmjet autoriteteve publike, pavarësisht se informacioni gjendet tek autoriteti delegues, duke nxjerrë në pah mungesën e efikasitetit dhe koordinimin e dobët. Dështimet në koordinimin e brendshëm mes autoriteteve publike pengojnë dhënien e përgjigjeve kërkesave të gazetarëve, intervistave ose deklaratave publike.⁹³


Këto shqetësime konfirmohen nga gjetjet e këtij sondazhi. Pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë se zbatimi i së drejtës për akses në informacion nga institucionet publike në Shqipëri është përkeqësuar (me 37.7% që tregojnë një “rënie të konsiderueshme” dhe 16,7% një “rënie të moderuar”).

⁹¹ [Fjalimi i Komisionerit në Konferencën VI për të Drejtën e Informimit, 2024](#)

⁹² [Fjalimi i Komisionerit në Konferencën VI për të Drejtën e Informimit, 2024](#)


⁹³ Intervistë me gazetar, Tirana, shtator 2024

Figura 38: “Si ka ndryshuar zbatimi i së drejtës për akses në informacion nga institucionet publike në Shqipëri gjatë vitit të kaluar?”, sipas gjinisë.



Të dhënat nxjerrin në pah shqetësime të shumta mes gazetarëve për përkeqësimin e aksesit në informacion nga institucionet publike në Shqipëri, veçanërisht mes atyre me më pak dhe me më shumë vite përvojë. Gazetarët me më pak se tre vjet dhe ata me më shumë se dhjetë vjet përvojë raportuan në shumicë dërrmuese një përkeqësim të aksesit në informacion, ku 61.6% dhe 61.2% e të dy grupeve ishin dakord me këtë pohim. Është për t'u theksuar se 44.9% e grupit me më shumë përvojë vunë re një “rënie të ndjeshme”, ndërkohë që 30.8% e grupit me më pak përvojë vunë re të njëjtën gjë. Nga ana tjetër, gazetarët me 4-6 dhe 7-10 vjet përvojë shfaqën perceptime më të balancuara, ku përqindje më të larta raportuan “Asnjë ndryshim” (përkatesisht 38.1% dhe 32.4%) dhe përmirësim të moderuar (16.7% dhe 14.7%).

Figura 39: “Si ka ndryshuar zbatimi i së drejtës për akses në informacion nga institucionet publike në Shqipëri gjatë vitit të kaluar?”, sipas përvojës së të anketuarit në gazetari



Këto gjetje theksojnë një mendim të përgjithshëm për rënien e transparencës, duke evidentuar pengesat sistematike për aksesin tek informacioni publik në Shqipëri. Pjesëmarrësit në tryezën e fundvitit me gazetarët shprehën shqetësimet për shpërndarjen e materialeve audiovizive dhe teksteve të parapërgatitura nga zyrtarët e shtetit dhe politikanët, duke i dhënë rëndësi rritjes së ndjeshmërisë kësaj çështjeje gjatë zgjedhjeve.⁹⁴ Kjo praktikë ua bën të pamundur gazetarëve dhe mediave të ushtrojnë funksionin e tyre mbikëqyrës dhe të ofrojnë informacione të verifikuara dhe të pavarura për audiencën e tyre. Një situatë e tillë bëhet pengesë e madhe për përpjekjet e Shqipërisë për integrimin në BE, ku transparenca dhe llogaridhënia janë standardet kryesore për progresin. Mungesa e publikimit proaktiv të informacionit dhe e efikasitetit administrativ në trajtimin e ankesave në lidhje me aksesin në informacion mund të pengojë ambiciet për anëtarësim.

⁹⁴ [Takimi i fundvitit me gazetarë: analiza e vitit 2024 dhe perspektiva për 2025 për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve, dhjetor 2024](#)

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1. Përfundime

Gjetjet e Raportit Vjetor 2024 nxjerrin në pah një mjedis kompleks dhe të vështirë për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në Shqipëri, pa progres të konsiderueshëm. Procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në BE ofron një kuadër të strukturuar për reforma; megjithatë, progresi në zbatimin e rekomandimeve të BE-së për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve mbetet i kufizuar, me rrezikun e të qenit një ushtrim thjesht “sa për të kaluar radhën” pa ndryshime domethënëse dhe ndikim real. Mangësitë e vazhdueshme në trajtimin e përqendrimit dhe transparencës së pronësisë së medias, kushteve të punës, aksesit në informacion dhe masave të sigurisë nxjerrin në pah nevojën për angazhim më të madh politik dhe rritjen e përpjekjeve për t’u përafruar me standardet evropiane.

Përqendrimi i madh i pronësisë së medias dhe mungesa e transparencës vazhdojnë të minojnë pavarësinë editoriale. Mbizotërimi i mediave private ndikon ndjeshëm në praktikën e gazetarisë, shpesh duke i dhënë përparësi interesave të biznesit apo politikës ndaj raportimit të paanshëm dhe interesit publik. Kjo situatë ngre shqetësime serioze për integritetin e përmbajtjes së medias dhe aftësinë e gazetarëve për të vepruar pa presione të panevojshme.

Siguria e gazetarëve mbetet një shqetësim urgjent, ku kërcënimet, presionet dhe frikësimet ndaj profesionistëve të medias janë përshkallëzuar vitet e fundit. Kërcënimet më bazë gjinore ndikojnë më shumë te gazetaret gra, duke përkeqësuar më tej dobësitë brenda sektorit të medias. Dobësitë e sistemit në reagimin institucional ndaj këtyre kërcënimeve dhe mungesa e masave të konsoliduara mbrojtëse i kanë bërë edhe më të vështira sfidat me të cilat përballen gazetarët në Shqipëri.

Nga ana tjetër, gazetarët durojnë kushte të pasigurta pune, të karakterizuara nga paga të ulëta, pagesa

joformale dhe të vonuara dhe mungesa e masave mbrojtëse profesionale. Këto kushte të pafavorshme nxisin autocensurën dhe i lënë profesionistët e medias përballë presioneve të jashtme, duke minuar pavarësinë e tyre dhe cilësinë e gazetarisë. Pavarësisht kuadrit ligjor që garanton aksesin tek informacioni publik, zbatimi i këtij kuadri ligjor bëhet me hope, ku institucionet publike shpesh dështojnë në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore. Kjo mungesë transparence dhe llogaridhënieje pengon më tej përpjekjet e gazetarëve dhe dobëson besimin e publikut.

Sfidat strukturore, si mungesa e mekanizmave të fuqishëm vetërregullues, zbatimi joefektiv i të drejtave të punës dhe mbështetja e kufizuar institucionale për gazetarët, pengojnë zhvillimin e një mjedisi të sigurt dhe të pavarur për mediat. Përveç kësaj, vonesat në zbatimin e masave të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës kanë implikime të mëdha në sigurinë e gazetarëve dhe pavarësinë e medias, duke reflektuar mangësitë në llogaridhënien dhe kapacitetin institucional.

Edhe pse Shqipëria ka bërë përpjekje për të përmbushur standardet e BE-së, asaj i mbeten përpara sfida të mëdha që kanë të bëjnë me sistemin dhe strukturën. Trajtimi i këtyre problemeve kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme që i jep përparësi lirisë, sigurisë dhe transparencës së medias si shtylla thelbësore për zhvillimin demokratik dhe anëtarësimin në BE.

5.2. Rekomandime

Përmirësimi i transparencës së pronësisë së mediave

- Të forcohet kuadri ligjor për të kufizuar përqendrimin e pronësisë së medias, për të rritur transparencën në financimin e mediave dhe për të krijuar mekanizma zbatimi për hetimin e shkeljeve të rregulloreve të pronësisë.

- Të përshtatet legjislacioni i medias për të garantuar përafrimin e përshtatshëm me Aktin Evropian për Lirinë e Medias.
- Të miratohet legjislacioni për të fuqizuar institucionet e pavarura për të hetuar interesat e fshehura të pronësisë, përqendrimin e tregut të mediave, konkurrencën e pandershme, sjelljen e koordinuar, shmangien e të drejtës së autorit dhe keqpërdorimin e fondeve dhe reklamave shtetërore në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës.
- Të fuqizohen institucionet e pavarura për të hetuar konfliktet e pronësisë dhe për të garantuar respektimin e rregullores së transparencës.
- Duke u bazuar tek progresi i AMA-s në publikimin e të dhënave të strukturës së pronësisë të rritet transparenca për të përfshirë konfliktet e interesit dhe influencat e fshehura, me qëllim që të garantohet llogaridhënia gjithëpërfshirëse.
- Të vendosen rregulla të qarta që rregullojnë shpërndarjen e reklamave shtetërore dhe burimet shtetërore për mallra dhe shërbime.
- Të forcohet bashkëpunimi ndërinstitucional për të ushtruar kontroll mbi përqendrimin e mediave dhe zbatimin efektiv të vendimit të AMA-s nr. 40/2024.

Angazhimi transparent i audiencës

- Të sigurohet një procesi i hapur, transparent dhe gjithëpërfshirës në hartimin e një metodologjie për matjen e audiencës për të arritur transparencën e medias dhe zbatimin gradual të Aktit Evropian për Lirinë e Medias.
- Të sigurohet transparenca e punës së Komitetit të Përbashkët të Industrisë dhe të përfshihen shoqatat e medias dhe organizatat e shoqërisë civile për të mbikëqyrur procesin.

Dialogu i strukturuar

- Të merret nga qeveria administrimi i dialogut të strukturuar për lirinë e medias duke caktuar një institucion për udhëheqjen e procesit si dhe të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha institucioneve dhe përfaqësuesve joinstitucionalë, puna e të cilëve ndikon në punën e gazetarëve, përfshirë por pa u kufizuar me Inspektoratin e Punës, Policinë, Prokurorinë, përfaqësues të sistemit gjyqësor.
- Të fillohet urgjentisht me vlerësimin e punës së Agjencisë së Medias dhe Informimit duke garantuar transparencë dhe llogaridhënie.
- Të bëhet transparent roli i Agjencisë së Medias dhe Informimit në procesin e integritetit në BE dhe si qëndron puna e saj përballë kuadrit të përgjithshëm institucional që adreson dezinformimin dhe ndërhyrjen e huaj me manipulim informacioni.

Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve

- Të sigurohet përafrimi i Direktivës së BE-së kundër padive SLAPP 2024/1069 për mbrojtjen e personave që angazhohen në pjesëmarrjen e publikut nga pretendimet e pabaza ose procedurat gjyqësore abuzive (paditë SLAPP) dhe zbatimin e Rekomandimit të Këshillit të Evropës CM/Rec(2024)2 për luftën kundër përdorimit të padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike.
- Të sigurohet pjesëmarrja aktive dhe harmonizimi me Platformën e Këshillit të Evropës për Sigurinë e Gazetarëve.
- Të institucionalizohen dhe konsolidohen personat e kontaktit të caktuar brenda Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë për të trajtuar sulmet ndaj gazetarëve, duke siguruar mandate të qarta dhe mbështetje të qëndrueshme.
- Të forcohet zinxhiri i hetimit, transparencës dhe reagimit për t'i dhënë fund mosndëshkimit të krimeve kundër gazetarëve.
- Të finalizohet dhe zbatohet protokoll i gjithëpërfshirës në Policinë e Shtetit për trajtimin e rasteve

të kërcënimit të gazetarëve, përfshirë këtu reagimet nga organizatat e mediave dhe shoqëria civile.

- Të përdoret qarkorja e Prokurorit të Përgjithshëm për të siguruar publikime sistematike, rast pas rasti të hetimeve që përfshijnë gazetarë.
- Të vazhdohet ngritja e kapaciteteve e agjencive përkatëse të zbatimit të ligjit, duke përfshirë trajnime të vazhdueshme dhe të përsëritura, për të nxitur praktika të qëndrueshme në mbrojtjen e sigurisë së gazetarëve.
- AMA të miratojë, tashmë të vonuar, Planin e Veprimit për sigurinë dhe mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve në mediat audiovizive deri në qershor 2025.
- Të përcaktohet një afat kohor i qartë për përgatitjen e ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin Penal; të sigurohet që një proces i tillë të jetë transparent, ku të përfshijë pjesëmarrjen e organizatave dhe shoqatave të mediave.
- Të fillohet vlerësimi i mangësive në zbatimin e një ligjit të posaçëm kundër padive SLAPP në Shqipëri.
- Të sigurohet transparenca dhe përfshirja e aktorëve të interesit në punën e grupit të punës të ngritur nga Policia e Shtetit për hartimin e Protokollit për Mbrojtjen e Gazetarëve dhe Trajtimin e Rasteve të Sulmeve dhe përcaktimi i afateve kohore të zhvillimit.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor të përmirësojë sistemin e statistikave online për rastet që përfshijnë gazetarët/punonjësit e medias sipas parashikimit në Udhërrëfyes dhe rekomandimeve të organizatave të medias dhe shoqërisë civile.

Trajtimi i kërcënimeve me bazë gjinore

- Të forcohen politikat organizative për të trajtuar kërcënimet dhe ngacmimet me bazë gjinore në vendin e punës në media, duke siguruar llogaridhënie.

- Të zgjerohen programet ekzistuese të trajnimit për t'u fokusuar veçanërisht në trajtimin e kërcënimeve me bazë gjinore në organet e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit.
- Të ngrihen rrjetet zyrtare mbështetëse për gazetare gra, duke ofruar mentorim dhe mekanizma raportimi të aksesueshëm për shqetësimet me bazë gjinore.
- Të ndërgjegjësohen dhe rriten kapacitetet e forcave të policisë, veçanërisht për njësitë jashtë kryeqytetit.

Përmirësimi i kushteve të punës

- Të sigurohet transparenca e punëdhënësve lidhur me respektimin e të drejtave të punës të gazetarëve dhe punonjësve të medias dhe respektimin e plotë të Kodit të Punës
- Të rritet zbatimi i të drejtave të punës duke përshpejtuar zbatimin e metodologjisë së inspektimit të bazuar në rrezik të Inspektoratit Shtetëror të Punës.
- Të rriten kapacitetet e Inspektoratit Shtetëror të Punës për të kryer inspektime të shpeshta dhe për të zbatuar masat kur punëdhënësit konstatohen në shkelje, duke siguruar që inspektimet të mos përdoren si mjet për presion apo mbytjen e zërit të mediave.
- Të rritet transparenca nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Punës lidhur me përdorimin e sistemeve që ka zhvilluar, Matrica e Dënimeve dhe Sistemi i Analizës së Riskut për rritjen e efikasitetit të tij. Një transparençë e tillë duhet të mbështetet nga të dhënat për numrin e inspektimeve, shpeshtësinë, masat e marra dhe për cilat subjekte në sektorin e mediave.
- Të bashkëpunohet me organizatat e gazetarëve dhe OJQ-të për të promovuar praktika të drejta të punës, duke përfshirë pagesën në kohë dhe aksesin në përfitimet sociale.
- Të rritet transparenca në trajnimet e synuara për ngritjen e kapaciteteve që ASPA po zhvillon për stafin e Inspektoratit Shtetëror të Punës; të publikohen kalendarit të trajnimit dhe informacione të

tjera që lidhen me trajnimin.

- Organizatat ndërkombëtare që punojnë me mediat private në vend të promovojnë dhe përfshijnë në kuadrin e tyre të punës klauzola të respektimit të Kodit të Punës dhe përmirësimit të kushteve të punës së gazetarëve.

Përmirësimi i aksesit në informacion

- Duke u mbështetur mbi progresin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, të vendosen kërkesa të detyrueshme të publikimit proaktiv të informacionit për institucionet publike.
- Të vendosen afate më të shkurtra, të detyrueshme për t'iu përgjigjur kërkesave për informacion, me gjoba për mosrespektim të tyre.
- Të trajtohen dështimet në koordinimin e brendshëm brenda autoriteteve publike për të siguruar përgjigje efikase dhe në kohë ndaj kërkesave të gazetarëve.
- Të përgatiten dhe zbatohen masat për rritjen e transparencës proaktive të institucioneve.
- Të mbështetet Komisioneri për të Drejtën e Informimit me rritje kapacitetesh për të hetuar dhe për t'iu përgjigjur në kohë kërkesave të gazetarëve, për të ndihmuar në ecurinë momentale të investigimit.
- Të vendosen më shumë gjoba dhe të merren masa të tjera më të ashpra nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit ndaj institucioneve që abuzojnë me të drejtën e informimit.
- Të zbatohen nga ana e institucioneve publike programe transparence dhe të nxitet komunikimi përmes kanaleve zyrtare, siç parashikohet me ligj.

Nxitja e vetë-rregullimit dhe etikës në gazetari

- Të sigurohet mbështetje financiare dhe teknike për nismat vetërregulluese si Aleanca për Gazetari

Etike dhe organizata të tjera gazetarësh dhe shoqëria civile për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

- Të bëhet e mundur njohja e autoritetit të organit vetërregullues brenda komunitetit dhe jashtë tij duke e përfshirë atë në ligj.
- Të nxitet respektimi i kodeve etike në mbarë sektorin përmes seminareve dhe angazhimit të qëndrueshëm me organizatat e mediave.
- Të nxitet bashkëpunimi ndërmjet mediave për të trajtuar kolektivisht çështjet sistematike si shpifja dhe autocensura.
- Të mbështetet transferimi i njohurive ndërmjet gazetarëve shqiptarë dhe atyre nga BE-ja për të promovuar vetërregullimin dhe gazetarët me etikë.

Angazhimi i mbështetjes ndërkombëtare

- Të forcohet bashkëpunimi me institucionet e BE-së për të përshpejtuar përafrimin me standardet evropiane të medias dhe për të siguruar financim për nismat për ngritjen e kapaciteteve.
- Të kërkohet ekspertizë teknike për hartimin dhe zbatimin e sistemeve transparente të matjes së audiencës për të përmirësuar përgjegjshmërinë e tregut të mediave.
- Të bëhen të mundura programet e shkëmbimit dhe ndarjes së praktikave më të mira me profesionistët e medias nga vendet anëtare të BE-së për të nxitur inovacionin dhe qëndrueshmërinë në sektorin shqiptar të mediave.



RAPORTI VJETOR 2024:

Ndjekja e progresit të Shqipërisë në lirinë e
mediave dhe sigurinë e gazetarëve në
përputhje me standardet e BE-së

